

SHBA

PAS ZGJEDHJEVE

Barack Obama - Ky njeri është një ishull



Politika

Botim elektronik | ASP në bashkëpunim me Bota.al. NENTOR 2014

Komente&Analiza nga:

David Lipton
Nouriel Roubini
Stephen Holmes
Ivan Krastev

Jan Techau
Gideon Rachman
David Rothkopf
Thomas L. Friedman etj



Muri i iluzioneve

Bota e re e krijuar nga rënia e Murit të Berlinit kishte lindur dhjetë vjet më parë. Por Europa nuk e kish kuptuar. 25 vjet më parë, ribashkimi i Berlinit. Është fundi i Luftës së Ftohtë. Dukej një shans i madh. Por Europa nuk diti të përfitojë. Kështu nisi një rënie e vështirë për t'u ndalur



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al



bota.al
Friday, June 20, 2014



Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqiperi
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Muri u shemb, por jehona e betejave s'u shua

THE GUARDIAN

Eshtë e vështirë të mbivlerësosh se çfarë mrekullie ishte që këto diktatura u shembën kaq paqësisht në 1989-ën. Në shekullin 20, kontinenti ynë ishte shkretuar nga dy luftëra. Pikërisht prej këtij shkatërrimi u ndërtua themeli i një projekti të përbashkët europian të paqes dhe begatisë, një arritje që – pavarësisht të gjithë problemeve që ka sot – mbetet politika më e mirë e sigurimit, që ne kemi kundër rënies në përsëritje

Një çerek shekulli më parë, harta e një kontinenti nisi të ribëhet. Përkundër pritshmërive, ndryshimi nuk po vinte për shkak të një prej atyre konfrontimeve të tmerrshëm mes shteteve, që gjithashtu po përkujtohen këtë fundjavë, dhe që kishin përcaktuar kufijtë e Europës dhe të shekullit 20 deri në atë kohë. Në vend të armëve dhe bombave, ishin çekanët që vërtiteshin prej sivilëve që krijuan skenën për një Europë të re dhe për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik – çekanë që shkëpusnin copat e pllakave

Eshtë e vështirë të mbivlerësosh se çfarë mrekullie ishte që këto diktatura u shembën kaq paqesisht në 1989-ën. Në shekullin 20, kontinenti ynë ishte shkretuar nga dy luftëra. Pikërisht prej këtij shkatërrimi u ndërtua themeli i një projekti të për-bashkët evropian të paqes dhe begatisë, një arritje që – pavarësisht të gjithë problemeve që ka sot – mbetet politika më e mirë e sigurimit, që ne kemi kundër rënies në përsëritje

të mëdha të betonit, të cilat prej dekadash kishin tharë zemrën e Berlinit, një simbol në dukje i pashkatërrueshëm i shtypjes dhe i ndarjes së Europës në dy blloqe.

Ndërkohë që Europa përpiqet në atë që duket si një tjetër luftë e ftohtë me Rusinë, ndoshta është koha të reflektojmë për mësimet e 1989-ës.

Njëri është që stabiliteti – pikësëpari, ai i regjimeve autoritarë – nuk është asnjëherë një siguri e përjetshme. Demonstruesit e rinj në Hong Kong, të cilët kanë kërkuar liri e demokraci në muajt e fundit, padyshim që e kanë këtë gjë në mendje. Një tjetër mësim është se sa larg kishte shkuar planeti me ndërlidhjen, shumë kohë përpara se të shfaqej Interneti. Revolucionet paqësorë të vitit 1989 u bënë të mundur sepse Mikael Gorbaçovi refuzoi përdorimin e forcës, për arsye se ai i frikej turpit ndërkombëtar që kish rënë mbi udhëheqjen kineze, kur kjo shtypi kryengritjen e sheshit të Tiananmenit pak muaj më herët.

Por shumëkush në aparatat sovjetik u godit prej një poshtërimit drithërues – tek shihnin të shastisur se si, përgjatë verës dhe vjeshtës, mijëra Europiano lindorë shtyeshin në vrimat që zgjeroheshin në perden e hekurt. Një lejtant në atë kohë i panjohur i KGB-së, i quajtur Vladimir Putin, ndiqte i dëshpëruar gjithë këto ngjarje që nga baza e tij në Drezden. Putini do të kujtonte më vonë në librin e tij me kujtime, “Në vetë të parë”, sesi kishte pritur më kot bashkë me kolegë të tjerë në zyrat e KGB-së, për reagimin e “Qendrës” (Moskës). Ishte kjo traumë, e shkaktuar nga të qënurit dëshmitar i shpërbërjes së një rendi të fuqishëm sovjetik prej pushtetit të popullit, që do ta shtynte më vonë Putinin ta përshkruante serinë e ngjarjeve të 1989-1991-shit si “katastrofën më të madhe gjeopolitike të shekullit 20”. I keqmenaxhoi apo jo Perëndimi marrëdhëniet e tij me Rusinë gjatë dy dekadave që pasuan, impakti psikologjik mbi njeriun që ka bërë më shumë se kushdo tjetër për të rikrijuar tensionet lindje-perëndim në kontinentin evropian, është shumë i fortë.

Në këndvështrimin që Putini ka për botën vazhdon të kumbojë tronditja e 1989-ës. Në shumë drejtime, aspiratat europiane të qytetarëve ukrainas, të demonstruara sërish në rezultatin e zgjedhjeve për parlamentin e ri në Kiev muajin që kaloi, janë vazhdimësia e frymës se përçuan shtetet europiano-lindorë 25 vjet më parë. Ky është një paralelizëm që Putini e konsideron jo vetëm irritues, por edhe si kërcënim.



Dërgimi kohët e fundit i avionëve bombardues rusë mbi qiejt e Europës, madje deri mbi Portugali, është një shenjë që zakonet e vjetër vështirë se harrohen.

Është e vështirë të mbivlerësohesh se çfarë mrekullie ishte që këto diktatura u shembën kaq paqësisht në 1989-ën. Në shekullin 20, kontinenti ynë ishte shkretuar nga dy luftëra. Pikërisht prej këtij shkatërrimi u ndërtua themeli i një projekti të përbashkët europian të paqes dhe begatisë, një arritje që – pavarësisht të gjithë problemeve që ka sot – mbetet politika më e mirë e sigurimit, që ne kemi kundër rënies në përsëritje.

Ndonëse sot është lehtësisht i kritikueshëm, ideali europian ndihmoi shtetet të transformoheshin për më mirë. Më pak se një vit pas rënies së Murit të Berlinit, Gjermania Lindore i ishte bashkuar komunitetit, e ribashkuar me perëndimin. Dhe në të vërtetë, në vitet që pasuan, Europa udhëhoqi një zgjerim i cili afroi shumë më tepër shtete, në 2004, 2007 dhe 2013, pasi kishte shërbyer si burim frymëzimi për reformat dhe demokratizimin. Nacionalizmi revizionist që buron nga Rusia sot ka si objektiv që të pengojë përhapjen drejt lindjes të vlerave dhe institucioneve europiane. Armiqtë e Ukrainës paralajmërojnë për brishtësinë e premtimit “Kurrë më!” të bërë ditën e Armëpushimit. Në qendër të hapësirës europiane, po krijohet një tjetër vijë ndarëse. Shkelja e sovranitetit të Ukrainës nga armët e rusëve dhe aneksimi i Krimesë janë dëshmi e një rendi europian ende të pavendosi. Fragmentet e Murit janë suvenirë sot, por betejat që çuan në shembjen e tij kanë një jehonë që vazhdon të zgjasë.



Muri i iluzioneve

La Sette

Bota e re e krijuar nga rënia e Murit të Berlinit kishte lindur dhjetë vjet më parë. Por Europa nuk e kish kuptuar. 25 vjet më parë, ribashkimi i Berlinit. Eshtë fundi i Luftës së Ftohtë. Dukej një shans i madh. Por Europa nuk diti të përfitojë. Kështu nisi një rënie e vështirë për t'u ndalur

Si është e mundur që, atje ku ra Muri, u fitua Lufta e Ftohtë mori fund ideja e ekonomisë së planifikuar, tashmë, 25 vjet më vonë, ka një kontinent kaq në krizë? Si ka mundësi që Europa, në teori përfituesja më e madhe nga fitorja e kapitalizmit mbi socializmin dhe nga rënia e Perdes së Hekurt, nuk ka ditur të korrë frutet e “dividentit të paqes”, për të cilin flitej në fillimet e viteve Nëntëdhjetë? Ajo natë e lavdishme, në 9 nëntor 1989, para Portës së Brandenburgut ishte një iluzion, një lajmërim për një të ardhme që nuk erdhi kurrë? Përgjigja – ose të paktën një pjesë domethënëse e përgjigjes – qëndron në faktin që, qysh atëherë, e kemi lexuar keq perspektivën historike: në vend që të festojmë 25-vjetorin e 1989-ës, duhet

Por, është e rëndësishme t'i rikthehemi 1979-ës për të thënë se Muri i Berlinit filloi të shpërbëhej atëherë, pikërisht kur Moska nisi një aventurë ekspansioniste që nuk mundej ta fitonte; Kina u nda ideologjikisht prej ekonomisë së planifikuar me vulën sovjetike; Irani doli nga skema dypolare, sipas të cilës kur humbte Amerika fitonte BRSS, dhe e anasjellta; Thatcheri dhe Reagani shpërthyen murin ideologjik që pretendonte të mbante në të njëjtin plan ekonominë e tregut dhe atë të planifikuar

ndoshta të festojmë 35-vjetorin e 1979-ës.

Ai që e ka afruar me dhjetë vjet historinë e pari, ka qenë Niall Ferguson, historian britanik, njëri prej më brilantëve. Nuk bëhet fjalë për një zhvendosje kohore: dallimi mes 89-ës dhe 79-ës është mbi të gjitha gjeografik. Në vitin 1979, bota pa revolucionin iranian, që solli rrëzimin e shiitëve dhe fillimin e një ringritje islamike me marrjen e pushtetit të ajatollahëve në Teheran.

Të shpallura në vitin 1978, një vit më vonë nisën reformat pro biznesit në Kinë; frymëzuesi i tyre, Ten Hsiaopini, kreu një udhëtim epokal në Shtetet e Bashkuara, i pari i një udhëheqësi të Pekinit që nga viti 1949. Ekonomia kineze u bë pjesë e asaj ndërkombëtare, një tërmet që e bëri të jetë sot e para në botë (në terma të paritetit të fuqisë blerëse). Gjithmonë në 1979-ën, Margaret Thatcheri u zgjodh Kryeministre e Mbretërisë së Bashkuar. Ishte fillimi i një vale liberale në ekonomitë e Perëndimit në fillim, dhe të botës më pas, mes privatizimeve, liberalizimeve dhe kufizimeve të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, që u fuqizua më tej në 1982-shin prej zgjedhjes së Ronald Reaganit në Shtëpinë e Bardhë. Dhe sërish në vitin 1979, Bashkimi Sovjetik, atëherë superfuqi në garë me Shtetet e Bashkuara, vendosi të pushtojë Afganistanin: ishte hapi i parë drejt rënies së shpejtë të viteve që pasuan, dhe më tej, shembjes.

Kjo, jo për të thënë se rënia e Murit të Berlinit, atë 9 nëntor të 25 viteve më parë, nuk kishte qenë një ngjarje me pasoja të jashtëzakonshme. E tillë ishte: i tregoi botës së perandoria sovjetike po shpërbëhej, që kapitalizmi kishte fituar, që komunizmi kishte dështuar, që demokracia kishte demonstruar se ishte më e fortë se autoritarizmi dhe diktatura. Tregoi që një epokë e cila kishte nisur me revolucionin e tetorit, që kishte vazhduar me ndarjet ideologjike në mesin e botës dhe ishte kristalizuar në përplasjen bërthamore mes dy superfuqive, po merrte fund. Dhe bashkë me të, edhe ndarja në dy kampe, në Europë dhe në Gjermani.

Por, është e rëndësishme t'i rikthehemi 1979-ës për të thënë se Muri i Berlinit filloi të shpërbëhej atëherë, pikërisht kur Moska nisi një aventurë ekspansioniste që nuk mundej ta fitonte; Kina u nda ideologjikisht prej ekonomisë së planifikuar me vulën sovjetike; Irani doli nga skema dypolare, sipas të cilës kur humbte Amerika fitonte BRSS, dhe e anasjellta; Thatcheri dhe Reagani shpërthyen murin ideologjik që pretendonte të mbante në



të njëjtin plan ekonominë e tregut dhe atë të planifikuar (deri në atë pikë që, në vitet Pesëdhjetë, CIA kishte parashikuar se dimensionin e ekonomisë sovjetike, në vitin 2000 do të ishte sa trefishi i asaj amerikane).

DALJA E FUQIVE TË REJA

Në këto ditë – siç thotë Ferguson – festojmë pra një vetëdijësim, ndoshta më të jashtëzakonshmin dhe spektakolarin në një shekull: megjithatë, jo vetëm “zbulimin” e fundit të komunizmit dhe të perandorisë sovjetike; por lajmin e një ndryshimi global, në të cilin çertifikohej vdekja e rendit të vjetër dypolar, por jo lindja – siç është thënë që atëherë – e një rendi njëpolar amerikan. Kemi patur më shumë lindjen e një mungese rendi të shkaktuar prej daljes së fuqive të reja i cili, siç shihet në krizat dramatike të ditëve të sotme, është shumë larg gjetjes së një pike ekuilibri. Nga njëra anë, kapitalizmi dhe demokracia kanë fituar.

Nga ana tjetër, janë çliruar fuqitë që kërkojnë një hapësirë të tyre, si Kina, Irani dhe Rusia post-sovjetike. Ose thjeshtë territoriale, si Kalifati i Islamit. Pra, rënia e Murit të Berlinit ishte me të vërtetë një ngjarje mbi të gjitha europiane, por u krijua prej forcave dhe tendencave që po vinin në diskutim rendin ndërkombëtar dhe shkonin përtej Kontinentit të Vjetër. U hodh në erë jo vetëm rendi i vendosur në fundin e Luftës së Dytë Botërore në Jaltë, por – siç e thotë Henry Kissingeri në librin e tij të fundit “Rendi Botëror” – ai shekullor, i dalë si model ekuilibri mes shteteve, që nga fundi i Luftës së Tridhjetë Viteve dhe Paqes së Vestfalisë, i cili për më shumë se 300 vite ka shërbyer si model për rendin botëror.

EUROPA, MES FRIKËRAVE DHE ILUZIONEVE

Atë natë të 9 nëntorit, berlinezët festonin. Mëngjesin tjetër, përballë magazinave të mëdha Kadeve, më të mëdhatë dhe më luksezet e pjesës perëndimore të qytetit, qindra banorë të Lindjes prisnin të hapeshin portat, për ditën e parë të “banjës” me konsumizëm të shëndetshëm: 10 nëntori ishte një ditë me numrin masimal të vizitorëve në historinë e Kadevesë. Qeveria gjermane, atëherë në Bon, dhe kancelari Helmut Kohl, u vunë në lëvizje duke patur në mendje idenë e ribashkimit (do të ndodhte më pak se një vit më vonë, në 3 tetor 1990). Qeveritë e Londrës, Parisit dhe Romës u mbërthyen nga ankthi, nxorrën duart përpara nga frika e një Gjermanie shumë të fortë. Në botë nuk flisnin për gjë tjetër: në Uashington, Moskë, Havanë, në pallatet e diktatorëve të kuq të Europës lindore, që nga ai moment do të rrëzoheshin edhe ata, në lëvizjet për çlirim në Amerikën e Jugut, natyrisht në Pekin, ku partia sapo kishte shtypur protestat në Sheshin e Tienanmenit dhe ishte e terrorizuar nga glaznosti i Mikael Gorbaçovit, në Nju Delhi që kishte jetuar për 40 vite me modelin sovjetik të ekonomisë së planifikuar, e që do ta hidhte poshtë vetëm një vit më vonë.

Po bëhej e qartë se një botë kishte marrë fund. Problemi ishte që, askush nuk qe në gjendje të imagjinonte si do të ishte e reja. Sot, 25 vjet më vonë, diçka është e dukshme. Që Europa do të tronditej prej rënies së Murit, kjo u kuptua menjëherë. Ideja që bëhej fjalë për një çështje mbi të gjitha europiane, krijoi iluzione dhe frikëra që shumë shpejt çuan drejt marrjes së vendimeve ndihmues, por jo domosdoshmërisht me vend. Iluzioni më i madh ishte ai i një dividendi të madh që do të vinte prej rënies së kufijve, dhe krijimit të një tregu të përbashkët europian. Realizuar vetëm pjesërisht, edhe për shkak të këshillave të këqia të diktatura prej frikës. Si për shembull, ato që shtynë drejt vendimit më të rëndësishëm: krijimit të Euros. Ishte një zgjedhje politike, tek e cila mbërritën Kohli dhe Mitterrandi, për të garantuar që një Gjermani e ribashkuar nuk do të kish patur tundimin për të vepruar e vetme dhe dominuar, por do të mbetej e lidhur me Europën.

Përtej rezultateve të begatisë ose jo, nga pikëvështrimi ekonomik dhe financiar, për zgjedhjen e krijimit të një monedhe të përbashkët, prapa vendimit ishte frika e një superGjermanie dhe leximi i 1989-ës, por jo i 1979-

Qeveritë e Londrës, Parisit dhe Romës u mbërthyen nga ankthi, nxorrën duart përpara nga frika e një Gjermanie shumë të fortë. Në botë nuk flisnin për gjë tjetër: në Uashington, Moskë, Havanë, në pallatet e diktatorëve të kuq të Europës lindore, që nga ai moment do të rrëzoheshin edhe ata, në lëvizjet për çlirim në Amerikën e Jugut, natyrisht në Pekin, ku partia sapo kishte shtypur protestat në Sheshin e Tienanmenit dhe ishte e terrorizuar nga glaznosti i Mikael Gorbaçovit

ës. Udhëheqësit europianë u sollën sikur ndryshimi kish të bënte vetëm me Europën dhe u përqëndruan në domosdoshmërinë për ta thelluar atë. Pra, për forcimin e kufijve të brendshëm – pikërisht Euro – më shumë se sa për t'i dhënë një dimension dhe një kolokacion ndërkombëtar, në një botë plot me ndryshime.

Nuk është rastësi që për një aspekt nuk diskutohet prej vitesh, përveçse në takimet dhe në konstatimet akademikë: mungesën e një politike të jashtme të BE-së.

DINAMIKAT E REJA NDËRKOMBËTARE

Edhe sot, 25 vjet më vonë, madje 35, Europa është zënë në befasi prej agresivitetit të Moskës dhe Vladimir Putinit. Mundohet shumë që të lexojë krizën e Lindjes së Mesme, shumë pranë sa u përket terroristeve dhe valëve të imigrantëve. U zu e papërgatitur nga pranverat arabe. Nuk arrin të merret seriozisht nga Kina dhe nga Azia.

Sa peshë ka patur, në këtë dimension të munguar ndërkombëtar që rrezikon ta mbajë në skajet e ekuilibrave të ardhshëm globalë, një lexim i kufizuar, i brendshëm i rënies së Murit të Berlinit? Në debatin që shoqëroi lindjen e monedhës së përbashkët, pati pozicioni që këmbëngulnin në nevojën jo vetëm për ta bërë BE-në dhe Eurozonën një njësi të bashkuar dhe homogjene përballë sfidave të globalizimit, por edhe për të krijuar një pol autonom dhe alternativ ndaj vetë fuqisë dominuese, SHBA: Euro, si bërthamë përreth të cilës të ndërtohej një bllok më pak atlantik dhe jo i dominuar nga Uashingtoni dhe nga dollari. Deri tani, kjo ide nuk ka gjetur këmbë për të marshuar. Megjithatë, ka mbyllur në vetvete Bashkimin European, e ka përqëndruar tërësisht mbi një krizë që vetë e ka krijuar, një monedhë unike pa arkitekturën institucionale në gjendje ta menaxhojë, dhe i paaftë të rrokë dinamikat ndërkombëtare. Iluzioni që rënia e Murit do ta rivendoste Europën në qendër të botës favorizoi zhvillimin e asaj sindrome të madhe që Fituesi i Nobelit, Mario Vargas Llosa e quan “ombligizmi”, domethënë të shohësh vetëm kërthizën tënde.

Realiteti i 25 viteve të fundit është që demokracia dhe ekonomia e tregut kanë bërë hapa gjigandë. Para rënies së Murit, vendet me demokraci zgjedhore nuk ishin më shumë se 40 dhe zinin një të tretën e popullsisë; sot, vendet ku votohet janë 120 dhe zënë dy të tretat e popullsisë së botës. Jo gjithnjë janë të përsosura, të lira dhe me ligje të sigurtë e të padiskutueshëm: pa-

Realiteti i 25 viteve të fundit është që demokracia dhe ekonomia e tregut kanë bërë hapa gjigandë. Para rënies së Murit, vendet me demokraci zgjedhore nuk ishin më shumë se 40 dhe zinin një të tretën e popullsisë; sot, vendet ku votohet janë 120 dhe zënë dy të tretat e popullsisë së botës. Jo gjithnjë janë të përsosura, të lira dhe me ligje të sigurtë e të padiskutueshëm: pa-

varësisht kësaj, ndryshimi ka qenë i madh. Megjithatë, demokracia është përballë sfidave të dukshme



*Të para me
lenten e rënies
së Murit të Ber-
linit – siç është
e drejtë të bëhet,
për aq sa kanë
qenë pasoja –
Euro dhe kriza
e saj nuk janë
më thjeshtë
çështje vetëm
ekonomie dhe
bilancesh pu-
blikë. Janë kriza
e përgjithshme
e një kontinenti
që ka qenë qen-
dra e botës për
disa shekuj dhe
25 vjet më parë
besoi se historia
do të ishte kaq
dashamirëse,
sa t'ia zgjaste
atë status edhe
në të ardhmen.
Nuk ndodhi*

hëm: pavarësisht kësaj, ndryshimi ka qenë i madh. Megjithatë, demokracia është përballë sfidave të dukshme. Në vendet islamikë, ajo është sprapsur në pjesën më të madhe prej islamit radikal. Në Rusinë e Putinit flitet mirë, por mohohet në praktikë. Dhe modeli autoritar kinez tërheq, pasi në dukje është eficient dhe produktiv në rrafshin ekonomik. Pra, ka një reagim kundër përparimit të demokracisë, siç e thotë prej tetë vitesh Freedom House në indeksin e saj të lirive demokratike.

Përballë kësaj situatë, vlerat transatlantike – demokracia, ligji, tregu i lirë – duhen mbrojtur dhe konsoliduar, marrëdhënia mes Europës dhe SHBA duhet forcuar. Nuk po ndodh. Vetëm pjesërisht për shkak të një çbilancimi të interesit amerikan drejt basenit të Paqësorit. Në pjesën më të madhe sepse Europa është e shpërqëndruar prej krizës së saj, prej ndjesisë së saj të dobësisë, nga ideja që është ende qendra e botës, në një kohë kur është e rrethuar nga fuqi që përpiqen të kenë hapësirën e tyre, legjitime, por shpesh jo demokratike dhe paqësore. Përgjigja e dobët ndaj agresionit rus në Ukrainë. Interesi pothuajse i munguar për vatrat e luftës dhe terrorizmit në Siri dhe Irak. Marrëdhënia e vëngërt me Iranin e ambicieve bërthamore. Mënyra e shkujdesur me të cilën përballoi rënien e Gedafit në Libi. Mungesa e peshës politike (më shumë se sa ekonomike) në Azi. Vështirësia në përshtatjen e sistemit të vet organizativ dhe social përballë sfidave që paraqet globalizimi i ekonomisë. Ja pra, nga forcat që u çliruan atë 9 nëntor të 1989-ës, madje dhjetë vite më herët, Europa është marrë vetëm me ato që i përkasin drejtpërdrejtë, jo me të tjerat, madje edhe me iluzionin që t'i lejonte vetes të bënte pa marrëdhënien transatlantike.

Të para me lentën e rënies së Murit të Berlinit – siç është e drejtë të bëhet, për aq sa kanë qenë pasoja – Euro dhe kriza e saj nuk janë më thjeshtë çështje vetëm ekonomie dhe bilancesh publikë. Janë kriza e përgjithshme e një kontinenti që ka qenë qendra e botës për disa shekuj dhe 25 vjet më parë besoi se historia do të ishte kaq dashamirëse, sa t'ia zgjaste atë status edhe në të ardhmen. Nuk ndodhi.



Europa Lindore, 25 vitet e tranzicionit

DAVID LIPTON

Sa shumë ndryshime mund të sjellin 25 vjet! Në vitin 1989, Europa Qendrore dhe Lindore nisi një transformim historik, nga komunizmi autoritar, tek kapitalizmi demokratik. Me kujtimet e sistemit të vjetër që tashmë kanë nisur të veniten, ia vlen që t'u hedhim një vështrim arritjeve të rajonit, të rishikojmë mësimet që janë nxjerrë, dhe të ekzaminojmë sfidat që ka përpara.

Do të ishte gabim të pretendonim se transformimi i rajonit ishte i pas-hmangshëm. Në fundin e Luftës së Ftohtë, ekonomitë e Europës Qendrore dhe Lindore ishin të rënduara prej pronësisë shtetërore dhe investimeve të përqëndruar në industritë e rënda. Politikat fiskale dhe monetare ishin fokusuar në rritjen e prodhimit industrial, pa marrë parasysh ekuilibrin makroekonomik, gjë që rezultonte në një tepri kronike të Kërkesës si dhe mungesa të mëdha. Për t'i përkeqësuar gjërat, pjesa më e madhe e rajonit – ku Cekosllovakia ishte një përjashtim i spikatur – ishte rrënuar prej borxhit të jashtëm dhe një inflacioni të lartë.

Ndërkohë, pak ekonomistë apo politikëbërës kishin bekgraundin e nevojshëm për të menaxhuar detyrat komplekse që gjendeshin para tyre. Aq e madhe ishte shkalla e tranzicionit të nevojshëm, sa që as makroekonomia

Megjithatë, peisazhi nuk është aspak rozë në të gjithë vendet. Disa prej tyre, sidomos në Ballkan dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarur, nuk e kanë përfunduar aspak tranzicionin dhe kanë përjetuar cikle të përsëritur të shpresës dhe krizës. Ashtu si kudo në botë, rritja ekonomike në rajon është ngadalësuar shumë, qysh prej fillimit të krizës financiare në vitin 2008. Ritmi i reformave është ngadalësuar në shumë vende – dhe ka patur sprapsje në disa prej tyre

moderne, as përvoja pothuajse 50-vjeçare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, nuk ofronin shumë udhërrëfim. Sfidat për t'u kapërcyer ishin të frikshme, dhe shumëkush mendonte se transformimi do të ishte i pamundur.

Katër ishin përbërësit kryesorë që kontribuan në tranzicionet e suksesshëm. Së pari, politikanë dhe politikëbërës kurajozë morën përsipër sfidën e hartimit të reformave jetike, si dhe shpjegimit të pasojave të tyre para një publiku i cili, me të drejtë, ishte dyshues. Ata e kuptuan natyrën historike të detyrës dhe e rrokën sfidën.

Së dyti, strategjitë e reformave u fokusuan pikërisht në thelbin: liberalizimin e çmimeve për të reflektuar pamjaftueshmërinë dhe lehtësimin e shpërndarjes së burimeve; stabilizimin e financave për t'u dhënë fund mungesave dhe inflacionit; dhe privatizimin e kompanive dhe aseteve shtetërore, me qëllim përmirësimin e qeverisjes dhe performancës së korporatave. Vendet që përqaftuan këto politika në përgjithësi patën edhe progresin më të shpejtë dhe më të plotë.

Së treti, premtimi i bashkimit me Europën pas shumë vitesh izolim, bashkë me angazhimin e Bashkimit Europian për zgjerimin, ofruan një tërheqje gravitacionale – dhe një model legjislativ – që i ndihmoi politikëbërësit të justifikonin dhe implementonin reforma të vështira. Ligjet jopopullorë ndonjëherë rrëzuan qeveri, por testi final i lakmusit për çdo politikë mbetej: “A do të na çojë sërish drejt Europës?”

Në fund, mbështetja e jashtme ndihmoi shtetet e zhytur në borxhe të rajonit që të përballonin ngarkesën e dyfishtë të implementimit të reformave strukturore dhe përballimit të paqëndrueshmërisë fiskale. Financimet nga FMN, Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe huadhënësit dypalësh, bashkë me çlirimet prej borxheve nga kredidhënësit zyrtarë dhe bankat tregtare, ndihmuan për uljen e presionit. Asistenca teknike, ndërtimi i kapaciteteve, dhe mbështetja për privatizimet – veçanërisht e bankave – e shtroi edhe më tej rrugën.

Në tërësi, progresi ka qenë mbresëlënës. Disa shtete të Europës Qendrore kanë arritur nivele të GDP për frymë (të matur sipas paritetit të fuqisë blerëse) që i vendosin në pjesën e poshtme të shkallës së të ardhurave të vendeve të eurozonës. Standartet e jetesës në rajon janë përmirësuar dukshëm – edhe pse një konvergencë e plotë me Europën Perëndimore është ende larg.

Megjithatë, peisazhi nuk është aspak rozë në të gjithë vendet. Disa prej tyre, sidomos në Ballkan dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarur, nuk e kanë përfunduar aspak tranzicionin dhe kanë përjetuar cikle të përsëritur të shpresës dhe krizës. Ashtu si kudo në botë, rritja ekonomike në rajon është ngadalësuar shumë, qysh prej fillimit të krizës financiare në vitin 2008. Ritmi i reformave është ngadalësuar në shumë vende – dhe ka patur sprapsje në disa prej tyre. Konsideratat gjeopolitike kanë ndërlikuar edhe më tej problemet, siç e demonstroi edhe konflikti në Ukrainë.

Dy janë skenarët që mund të rezervojë e ardhmja. Në të parin, rajoni rrezikon një cikël rritjeje ekonomike të dobët, tërheqje nga politikat e orientuara nga tregu, si dhe një rritje të zhgënjimit. Si rezultat, konvergjenca me Perëndimin mund të ndalet, teksa shumë vende do të mbeten



mbrapa – një rezultat shumë i ndryshëm nga ai që parashikohej gjatë bumit ekonomik të viteve 2000, atëherë kur konvergjenca brenda një brezi dukej pothuajse si një e drejtë e lindur.

Në skenarin e dytë, më pozitiv, konvergjenca e shpejtë me nivelet e të ardhurave të ekonomive të përparuara vazhdon, e mbështetur me një fokus tek dy prioritetet, që janë të detajuar në një raport të ri të FMN-së. Një angazhim i ri ndaj qëndrueshmërisë makroekonomike dhe financiare, i lejon qeveritë t'u vënë fre deficiteve të vazhdueshëm dhe rritjes së borxheve, si dhe të merren me vëllimin në rritje të huave të këqia në ekonomitë e tyre. Ndërkohë, reformat më të thella strukturore përmirësojnë klimën e biznesit dhe investimeve, zgjerojnë qasjen në kredi, hapin më shumë tregjet e punës, kontrollojnë shpenzimet publike, si dhe fuqizojnë administratën e taksimit – të gjithë elementë që i vendosin këto ekonomi në rrugën e një rritjeje të qëndrueshme dhe të shpejtë.

FMN, nga ana e vet, ka qenë një partner i përkushtuar në Europën Qendrore dhe Lindore dhe transformimin e saj gjatë këtyre 25 viteve të fundit. Dhe sot është gati që të ndihmojë vendet e rajonit për ta bërë po kaq mbresëlënës çerekshkullin e ardhshëm. /Project Syndicate/

David Lipton është Zevendesdrejtor i Pergjithshëm i Fondit Monetar Nderkombetar



Ekonomia globale po fluturon me një motorr. Por ka turbulenca...

NOURIEL ROUBINI

Ebola dhe ndryshimet klimatike, nuk kanë shkaktuar ende një epidemi financiare. Megjithëkëtë, ato janë duke ngadalësuar shpenzimet kapitale dhe konsumin, duke patur parasysh opsionin e pritjes gjatë kohëve të pasigurta. Pra ekonomia globale po fluturon me një motorr të vetëm, pilotëve u duhet të navigojnë me sy nëpër stuhi dhe re, ndërkohë që mes pasagjerëve shpërthejnë vazhdimisht zënka. Sikur të kishte ekipe të emergjencës në tokë...

Ekonomia botërore është si një avion që ka nevojë t'i ketë të gjithë motorrët në punë për t'u ngritur dhe për të dalë mbi retë dhe stuhitë. Fatkeqësisht, vetëm njëri prej katër motorrëve po funksionon si duhet: Anglosfera (SHBA dhe kushëriri i saj i afërt, Britania e Madhe). Motorri i dytë – eurozona – tashmë është ndalur, pas një rifillimi anemik pas vitit 2008. Në fakt, Europa është një hap larg deflacionit dhe një tjetër goditjeje recesioni. Po kështu, motorrit të tretë, Japonisë, po i mbaron

*Ndërkohë,
paqëndrueshmëria e
tregjeve është
rritur, dhe një
korrigjim është
në rrugë e sipër.
Lajmet e këqinj
makro mund
të jenë të mirë
për tregjet,
sepse vetëm
një politikë e
menjëhershme
mund të rrisë
çmimet e asete-
ve. Por, lajmet
e këqinj makro
të kohëve të
fundit kanë
qenë të këqinj
për tregjet, për
shkak të percep-
timit të inercisë
së politikave*

karburanti pas një viti stimujsh fiskalë dhe monetarë. Dhe tregjet në zhvillim (motorri i katërt) po ngadalësojnë dukshëm, teksa erërat e favorshme disadekadëshe – rritja e shpejtë ekonomike e Kinës dhe lehtësimi sasior i Bankës Qendrore të SHBA (FED, si dhe supercikli i produkteve – po shndërrohen në erëra të disfavorshme.

Kështu që pyetja është nëse – dhe për sa kohë – ekonomia botërore mundet të qëndrojë në ajër, me një motorr të vetëm. Dobësia në pjesën tjetër të botës do të thotë një dollar më i fortë, gjë që do të dobësojë rritjen ekonomike të SHBA. Sa më i fortë ngadalësimi në shtetet e tjerë, aq më lart ngrihet dollari, dhe aq më pak e aftë do të jetë SHBA të shkëputet prej panikut të të tjerëve, edhe pse kërkesa e brendshme duket e fortë.

Rënia e çmimeve të naftës mund të ofrojë energji më të lirë për prodhuesit dhe familjarët, por këta dëmtojnë eksportuesit e energjisë dhe shpenzimet e tyre. Dhe ndërkohë që rritja e ofertës – sidomos prej vendburimeve të rërave argjilore në Amerikën e Veriut – ka ulur trysinë mbi çmimet, po kështu ka ndikuar edhe kërkesa e dobësuar në eurozonë, Japoni, Kinë dhe shumë tregje në zhvillim. Veç kësaj, rritja e çmimeve të naftës shkakton një rënie të investimeve për kapacitete të rinj, duke e dëmtuar edhe më shumë kërkesën globale.

Ndërkohë, paqëndrueshmëria e tregjeve është rritur, dhe një korrigjim është në rrugë e sipër. Lajmet e këqinj makro mund të jenë të mirë për tregjet, sepse vetëm një politikë e menjëhershme mund të rrisë çmimet e aseteve. Por, lajmet e këqinj makro të kohëve të fundit kanë qenë të këqinj për tregjet, për shkak të perceptimit të inercisë së politikave.

Në të vërtetë, Banka Qendrore Europiane po nguron në lidhje me vendimin sa ta zgjerojë buxhetin me blerje të bonove sovraane, ndërkohë që Banka e Japonisë vetëm tani vendosi të rrisë normën e saj të lehtësimit sasior, duke parë provat që rritja e taksës mbi konsumatorin për këtë vit po pengon rritjen ekonomike dhe që rritja e planifikuar e taksave për vitin e ardhshëm do e dobësojë edhe më tej.

Sa për politikën fiskale, Gjermania vazhdon t'i rezistojë një pakete stimuluese aq të nevojshme për t'i dhënë një shtysë kërkesës së Eurozonës. Dhe Japonia duket se ka ndërmend të "shkaktojë" vetes një tjetër rritje të taksës së konsumit, gjë që do të ngadalësonte edhe më tej rritjen ekonomike.

Po kështu, FED në SHBA ka dalë tashmë nga lehtësimi sasior dhe po tregon një gatishmëri për të nisur normat e interesit më herët nga sa parashikojnë tregjet. NëSE FED nuk vonon rritjen e normave deri kur të kemi një qartësim të motit ekonomik global, ajo rrezikon një "ngritje të dështuar" – dhe ky ka qenë fati i shumë ekonomive në vitet e fundit.

Nëse Partia Republikane merr kontrollin e plotë të Kongresit pas këtyre zgjedhjeve të mesmandatit, bllokada e politikave ka gjasë të përkeqësohet, duke rrezikuar një rikthim të betejave të dëmshme fiskale që shkaktojnë një mbyllje të zyrave qeveritare vitin që kaloi dhe pothuajse një mospagim teknik të borxhit. Më gjerësisht, bllokada do të pengojë miratimin e reformave të rëndësishme strukturore që i nevojiten aq shumë SHBA për rritjen ekonomike.

Edhe vendet e mëdhenj në zhvillim janë në telashe. Nga pesë ekonomitë e BRICS (Brazil, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut), tre prej tyre (Brazil, Rusia dhe Afrika e Jugut) janë pranë recesionit. Më e madhja, Kina, është në mesin e një ngadalësimi strukturor që do e shtyjë normën e saj të rritjes ekonomike pranë 5 përqindëshit në dy vitet e ardhshëm, nga mbi 7 përqind që është sot. Në të njëjtën kohë, reformat aq të kërkuara për të riekulibruar rritjen ekonomike, nga investimet fikse tek konsumi, po shtyhen në kohë deri kur presidenti Xi Jinping të konsolidojë pushtetin e tij. Kina mund të shmangë një ulje të vështirë, por gjithësesi ajo nuk do të jetë pa telashe.

Risku i një falimenti global ka qenë i ulët, sepse ulja e përqindjes së borxhit në ekonomi ka ecur me shpejtësi në shumicën e ekonomive të përparuara;

Ky kombinim i borxheve të lartë dhe rritjes së pabarazisë mund të jetë burimi i stanjacionit që po i bën reformat strukturore më të vështira politikisht. Ngjitja e partive nacionaliste dhe populiste në Europë, Amerikën e Veriut dhe Azi po sjell një valë kundër tregtisë së lirë dhe migrimit të krahut të punës, gjë që mund ta dobësojë më tej rritjen ekonomike globale. Në vend të rrisin kredinë për ekonominë reale, politikat monetare jotradicionale kanë rritur kryesisht pasurinë e shumë të pasurve – përfituesit kryesorë të riflacionit të aseteve

efektet e ngadalësimit fiskal janë më të vogla; politikat monetare mbeten akomoduese; dhe riflacioni i aseteve ka patur efekte pozitive. Po kështu, ekonomitë e vendeve në zhvillim po rriten fuqishëm, po u përmbahen politikave të shëndetshme makroekonomike dhe po fillojnë të vënë në zbatim reforma strukturore që fuqizojnë rritjen ekonomike. Dhe rritja në SHBA, e cila aktualisht e kalon prodhimin potencial, mund të ofrojë një ngritje të mjaftueshme globale – të paktën për momentin.

Por përpara ka sfida serioze. Borxhet publik dhe privat në ekonomitë e përparura janë ende të lartë dhe në rritje – dhe janë potencialisht të përballueshëm, sidomos në eurozonë dhe Japoni. Rritja e pabarazisë po i rishpërndan të ardhurat tek ata që janë më të prirur të kursejnë (të pasurit dhe korporatat) si dhe po përshkallëzohet edhe prej risive teknologjike të prirura nga kapitali dhe reduktimi i krahut të punës.

Ky kombinim i borxheve të lartë dhe rritjes së pabarazisë mund të jetë burimi i stanjacionit që po i bën reformat strukturore më të vështira politikisht. Ngjitja e partive nacionaliste dhe populiste në Europë, Amerikën e Veriut dhe Azi po sjell një valë kundër tregtisë së lirë dhe migrimit të krahut të punës, gjë që mund ta dobësojë më tej rritjen ekonomike globale. Në vend të rrisin kredinë për ekonominë reale, politikat monetare jotradicionale kanë rritur kryesisht pasurinë e shumë të pasurve – përfituesit kryesorë të riflacionit të aseteve.

Fatmirësisht, risqet gjeopolitike që janë shfaqur – një Lindje e Mesme në flakë, konflikti Ukrainë-Rusi, trazirat në Hong Kong dhe mosmarrëveshjet territoriale të Kinës me fqinjët – bashkë me rreziqet gjeoekonomike nga Ebola dhe ndryshimet klimatike, nuk kanë shkaktuar ende një epidemi financiare. Megjithëkëtë, ato janë duke ngadalësuar shpenzimet kapitale dhe konsumin, duke patur parasysh opsionin e pritjes gjatë kohëve të pasigurta. Pra ekonomia globale po fluturon me një motor të vetëm, pilotëve u duhet të navigojnë me sy nëpër stuhi dhe re, ndërkohë që mes pasagjerëve shpërthejnë vazhdimisht zënka. Sikur të kishte ekipe të emergjencës në tokë...

/Project Syndicate/

Nouriel Roubini ka qenë Krye-Ekonomist për Cështjet Ndërkombëtare në Këshillin e Këshilltarëve Ekonomikë të Shtëpisë së Bardhë



Putini mbi akull

STEPHEN HOLMES & IVAN KRASTEV

Veprimet e Rusisë në Donbas mund të jenë më simbolikë dhe oportunistë, se sa strategjikë. Por kjo nuk i bën më pak të rrezikshëm. Putini e ka humbur tashmë iniciativën që rroku në Krime, duke e shndërruar betejën e përgjakshme për Donbasin në një ngërç të pazgjidhshëm. Me çmimet e naftës që bien, Putini mund të ndihet tashmë i detyruar që të bëjë një tjetër lëvizje të dëshpëruar dhe shkatërrimtare, me shpresën për të bindur botën se është ai në kontroll të situatës

Temperaturat globale po rriten, por konfliktet e ngrirë të ish Bashkimit Sovjetik nuk po shfaqin shenja shkrirjeje. Përkundrazi, akulli po zgjerohet. Mbështetja e Rusisë për zgjedhjet e mbajtura nga separatistët në Donetsk dhe Luhansk – qytete kyçe në rajonin e Donbasit – tregon se Kremli ka vendosur të krijojë një tjetër “mini Luftë të Ftohtë” gjysmë-permanente,

Duke krijuar një konflikt të ngrirë në Donbas, Rusia i ka ngulur një gjemb Ukrainës dhe në terma kohëshkurtër, i ka ndërlikuar marrëdhëniet mes presidentit ukrainas, Petro Poroshenko dhe Kryeministrit të vendit, Arseniy Yatsenyuk. Por ai ka garantuar gjithashtu që, në terma kohëgjatë, shteti ukrainas do të konsolidohet përreth ndjenjave dhe politikave antiruse – që do të thotë se Rusia nuk do të jetë në gjendje të normalizojë marrëdhëniet me Ukrainën për disa dekad

këtë herë në zonat e kontrolluara nga rebelët, të fqinjit më të rëndësishëm të Rusisë. Por “ngrirja” dhe përjashtimi nga rajoni i qeverisë legjitime të Ukrainës është ndoshta shumë më destabilizuese se sa mbështetja e Kremlinit për territore të tjerë ish sovjetikë: Transnistria e Moldavisë dhe rajonet gjeorgjianë të Abkhazisë dhe Oshetisë së Jugut.

Duke e turbulluar kufirin e saj me Ukrainën, Rusia po krijon një marrëdhënie të re me një entitet anormal, të panjohshëm ndërkombëtarisht, i cili kulturalisht dhe historikisht i përket jo “Novorossiyan” imagjinare të shpallur nga separatistët, por Bashkimit Sovjetik “të pavdekur”. Pyetja është, përse presidenti rus, Vladimir Putin dhe enturazhi i tij e shohin një konflikt të ngrirë në Donbas, i krijuar për të prodhuar një marrëveshje politike ose paqe jetëgjatë, si një rezultat pozitiv për vendin e tyre.

Brenda kufijve të tyre aktualë, Donetsk dhe Luhansk kanë një rëndësi strategjike të papërfillshme për Rusinë. Po kështu, një Donbas i pavarur, do të sillte kosto të mëdha për Rusinë, e cila supozohet që do të detyrohej të rindërtonte dhe mbante në këmbë një ekonomi ku do të mungonin të gjithë investimet e tjerë të huaj.

Ndryshe nga Transnistria apo Abkhazia, Donbasi është një rajon i industrisë së rëndë dhe i varur prej subvencioneve; infrastruktura e tij është e shkatërruar; dhe bizneset aty janë kryesisht në pronësi të oligarkëve, të cilët janë larguar për në Kiev, Londër, Paris dhe jo në Moskë, për t’i shpëtuar konfliktit. Shtoji kësaj edhe statusin ligjor të parregullt të këtyre “republikave popullore” të vetëshpallura, (i cili ua bën të pamundur prodhuesve industrialë të Donbasit të bëjnë tregti me botën, dhe perspektiva ekonomike (dhe sociale) e rajonit duket e pashpresë.

Qytetarët e rajoneve të tjerë prorusë u janë nënshtruar prej kohësh sistemeve të tyre të varfër “feudalo demokratikë”, në të cilët udhëheqësit vendas zhvillojnë zgjedhje të manipuluar dhe e ngrejnë pushtetin e tyre mbi korrupsionin dhe patronazhin e stilit mafioz. Pas muajsh premtime boshe nga udhëheqësit separatistë, qytetarët e Donetskut dhe Luhanskut nuk ka gjasa që të pranojnë në heshtje transformimin e Donbasit në një tjetër njësi të izoluar ndërkombëtarisht, që i shkon më shumë për shtat rrjeteve kriminale me qendër në Rusi.

Duke krijuar një konflikt të ngrirë në Donbas, Rusia i ka ngulur një gjemb Ukrainës dhe në terma kohëshkurtër, i ka ndërlikuar marrëdhëniet mes presidentit ukrainas, Petro Poroshenko dhe Kryeministrit të vendit, Arseniy Yatsenyuk. Por ai ka garantuar gjithashtu që, në terma kohëgjatë, shteti ukrainas do të konsolidohet përreth ndjenjave dhe politikave antiruse – që do të thotë se Rusia nuk do të jetë në gjendje të normalizojë marrëdhëniet me Ukrainën për disa dekada.

Gjithashtu, mbështetja e Putinit për separatistët e Donbasit është gozhdë e fundit në arkivolin e projektit të tij të integritetit rajonal, një Union Ekonomik Euraziatik i udhëhequr nga Rusia. Ironikisht, ambiciet e Rusisë për këtë Union janë ato që nxitën reagimin e saj me forcë ndaj zhvendosjes së Ukrainës drejt perëndimit, teksa Putini pranonte që, pa Ukrainën, blloku nuk do të përmbyshte vizionin e tij si një rival i mundshëm ndaj Bashkimit Europian. Megjithatë, shkelja flagrante dhe e pafalshme që Rusia i ka bërë integritetit territorial të Ukrainës jo vetëm i ka dëmtuar marrëdhëniet me Kievin; ajo kërcënon gjithashtu edhe kandidatët e tjerë për anëtarësim në Unionin Ekonomik Euraziatik, sidomos Kazakistanin, shtetësinë e pavarur të të cilit Rusia e ka vënë tashmë haptaz në dyshim.

Cila është dobia gjeopolitike për Rusinë, në shndërrimin e një Donbasi të paqëndrueshëm në një “instalim” të përhershëm në skajin e vet jugor? Përse Kremlini duhet të tregojë “respekt” për zgjedhje që praktikisht asnjë shtet tjetër nuk i njeh?

Përgjigja mund të jetë thjeshtë që Kremlini që e ka vënë veten pas qoshes. Mediat shtetërore ruse, bashkë me nacionalistët në vend, kanë ushqyer një atmosferë publike të ndërkryer, e cila e privon nga fleksibiliteti politikën e Rusisë kundrejt Ukrainës. Në vend të një strategjie gjithëpërfshirëse,

Kremlini po mbështetet në veprime ad hoc për të siguruar që publiku rus të mos e shohë sikur po tradhëton rebelët në Ukrainë. Nga ana e tyre, udhëheqësit rebelë ukrainas, që nuk duan të humbasin qendrat e fituara së fundmi, po llobojnë fort kundër çdo lloj afrimi mes qeverive ruse dhe ukrainase.

Në të njëjtën kohë, Putini dëshiron t'i tregojë Perëndimit se politikat e tij kundrejt Rusisë, duke përfshirë edhe sanksionet e ashpër ekonomike, nuk do të funksionojnë. Krijimi i më shumë konflikteve të ngrirë, që Perëndimi i urren por është i pafuqishëm t'i zgjidhë, mund t'i duket si një mënyrë për ta arritur këtë.

Shkurt, veprimet e Rusisë në Donbas mund të jenë më simbolike dhe oportuniste, se sa strategjike. Por kjo nuk i bën më pak të rrezikshëm. Putini e ka humbur tashmë iniciativën që rroku në Krime, duke e shndërruar betejën e përgjakshme për Donbasin në një ngërç të pazgjidhshëm. Me çmimet e naftës që bien, Putini mund të ndihet tashmë i detyruar që të bëjë një tjetër lëvizje të dëshpëruar dhe shkatërrimtare, me shpresën për të bindur botën se është ai në kontroll të situatës. Megjithatë, përpjekjet për të identifikuar ndonjë vizion të madh strategjik prapa taktikave të tilla, do të vazhdojnë të jenë të kota.

Përballë tryfnisë nga të gjithë anët, Putini po e humbet pikëmbështetjen gjeostrategjike. Arritjet e tij në politikën e jashtme gjatë vitit të fundit nuk duhet të mbivlerësohen. Duke aneksuar Krimenë, ai humbi Ukrainën. Dhe duke "ngrirë" Donbasin, ai pothuajse e ka gruposur një herë e mirë ëndrrën e tij pothuajse-imperiale për ndërtimin e Unionit Ekonomik Euraziatik.

Project Syndicate



PAUL KENNEDY: “Amerika nuk është më në rënie. Europeanët po”

SKENARE / Refleksionet e historianit britanik, Paul Kennedy, mbi të ardhmen gjeopolitike. “Në krahasim me vitet Tetëdhjetë, globalizimi ka ndryshuar gjithçka, nuk ka më BRSS, Japonia ia ka lënë vendin Kinës, Islami është një e panjohur. Nuk besoj se rendi botëror që u krijua pas 1945-ës do të mbijetojë në përjetësi”

Paul Kennedy bën dallimin mes qytetërimit dhe perandorisë, mes rënies dhe kolapsit. Një herë e një kohë, vëren historiani, shumë shpesh qytetërimi dhe perandoria përkonin – me ndonjë përjashtim, si në rastin e Greqisë së lashtë. Sot nuk përkojnë më. Dhe ndërkohë që një perandori mund të shembet papritur – i ndodhi BRSS në vitin 1991 – një qytetërim zakonisht shkon në kolaps në fundin e një rënieje që jo rrallëherë është shekullore. Veç kësa, shton Kennedy, koncepti i rënies së një qytetërimi nuk është absolut: “Është rënie në krahasim me të kaluarën e tij, apo ngjitjen e një qytetërimi tjetër”. Mund të hajë diskutim, nëse sot qytetërimi perëndimor

po shkon drejt rënies, pohon autori i “Ngjitja dhe rënia e fuqive të mëdha”, por nuk është domosdoshmërisht e thënë që të shkojë drejt kolapsit.

Ju nuk besoni se krizat që trondisin Perëndimin – recesioni ekonomik dhe terrorizmi, imigrimi dhe kataklizmat natyrore – janë simptoma të rënies së tij?

Janë kriza që shkaktojnë pesimizmin aktual. Por, sipas meje, nuk tregojnë që dekadenca e qytetërimit perëndimor është pranë. Që prej vitit 1922 flitet për “rënie të Perëndimit”, domethënë që nga koha e botimit të librit të historianit dhe filozofit gjerman Oswald Spengler, që mban këtë titull. Është e vërtetë që Perëndimi ndodhet në vështirësi serioze, por në paranojën e sotme globale, shteti që udhëheq Perëndimin, domethënë Amerika, nuk është në rënie. Europa është, megjithatë ka gjithë kohën në dispozicion për të rimarrë veten.

Po a nuk ishit edhe ju pesimist pesë vjet më parë, për Amerikën dhe për Perëndimin?

Isha pesimist, sepse e shihja Amerikën të tejngarkuar në planin ushtarak, të zhytur në borxhe në planin ekonomik, të paralizuar në planin politik. Tani jam optimist, ndonëse i matur, sepse e shoh të tërhequr prej luftërave në Irak dhe në Afganistan, fitimtare ndaj terrorizmit, dhe pothuajse të dalë nga kriza ekonomike më e rëndë që e kish pllakosur, qysh prej Depresionit të Madh të viteve Tridhjetë. Amerika është ende e ndarë nga politika – por përmirësimi nuk ka fare të bëjë me fitoren e republikanëve në zgjedhjet e mesit të mandatit – dhe megjithatë e ka shmangur rënien të cilës unë i druhesha, të paktën për momentin.

E kujt është merita?

Politikanët këmbëngulin që është e tyrja. Unë mendoj se Obama bërë më mirë nga sa mendojnë zgjedhësit amerikanë. Por merita kryesore është e burimeve të jashtëzakonshëm njerëzorë dhe natyrorë që ka Amerika. Ajo nuk lejoi që të kushtëzohet prej politikanëve të partive që i kundërvihen njëra-tjetrës dhe u përqëndrua në rimëkëmbjen ekonomike, ndryshe nga Europa, që megjithatë ia ka dalë t’u mbijetojë furtunave të tregjeve dhe rreziqeve ndaj Euros.

E megjithatë thuhet se ky nuk do të jetë më shekulli amerikan, siç ishte i XX-i, por do të jetë shekulli kinez.

Nuk më duket se aktualisht Amerika është në rënie, qoftë edhe kundrejt Kinës. Jo vetëm fuqia, por edhe diplomacia dhe teknologjia amerikane dominojnë dhe do të vazhdojnë ta dominojnë edhe për shumë kohë botën. Ngjitja e Kinës ka qenë më e shpejtë nga sa parashikohej, por në vitet e fundit është ngadalësuar. Dhe tani, udhëheqja kineze duhet të bëjë llogaritë me probleme që e ka të vështirë t’u japë zgjidhje.

E megjithatë, a nuk rrezikojnë fillimin e rënies, polarizimi politik dhe problemet sociale të Amerikës?

Një herë, një televizion arab, më pyeti se kur do të zhduket perandoria amerikane. Paradoksale. E si mund të thuhet? Herët a vonë, edhe Amerika do të “perëndojë”, por për momentin mundet vetëm të thuhet se do të vazhdojë të lulëzojë. Më shumë se dy shekuj më parë, kur Anglia i humbi SHBA-të, Edmund Burke shkruante se Perandoria britanike kishte marrë fund. Gabohej. Britania e Madhe i komandoi oqeanet edhe për 150 vjet.

Nuk më duket se aktualisht Amerika është në rënie, qoftë edhe kundrejt Kinës. Jo vetëm fuqia, por edhe diplomacia dhe teknologjia amerikane dominojnë dhe do të vazhdojnë ta dominojnë edhe për shumë kohë botën. Ngjitja e Kinës ka qenë më e shpejtë nga sa parashikohej, por në vitet e fundit është ngadalësuar. Dhe tani, udhëheqja kineze duhet të bëjë llogaritë me probleme që e ka të vështirë t’u japë zgjidhje

E di që jam kundër rrymës, por duhet të jetë më elastike, më solidare dhe më pragmatiste, duhet të përparojë më gradualisht drejt integritetit. Protesta popullore kundër establishment-it europian, politika dhe partitë duhet të kontrollohen, sepse ushqejnë shumë nacionalizmat. Europeanët kanë një trashëgimi të përbashkët, që me kalimin e kohës do i lejojë të arrijnë shumë objektiva.

Kush mund të fajësohet për rënien që po pëson Europa?

Duhet të themi që, përveç Gjermanisë, Europa është në rënie po ta krahasosh me Amerikën dhe Kinën, por jo po ta krahasosh, për shembull, me islamin. Shkaku i kësaj rënie relativ nuk është vetëm mungesa e ekuilibrit mes masave të kursimit dhe rritjes ekonomike në Europë. Janë edhe ambicia e tepruar e projektit europian, pushteti i tepruar i burokracisë së Brukselit, ngurtësia e Gjermanisë, gjendja e vështirë e shteteve anëtarë të rëndësishëm, si Franca dhe Italia.

A është e kthyeshme rënia e Europës?

Rënia e qytetërimeve të mëdhenj është e kontrollueshme dhe e kthyeshme, ndonëse jo gjithmonë. Nuk është vetëm çështje lidërshipi, por edhe kulture, vullneti, pjesëmarrjeje. Perandoria e Habsburgëve dhe Perandoria Otomane, simbole respektivisht të qytetërimit perëndimor dhe qytetërimit islamik, arritën të rigjallërohen për dy të tretat e një mijëvjeçari, në formë dhe me fuqi të ndryshme. Rënia e tyre filloi në Tetëqindën dhe Lufta e Parë Botërore shkaktoi shembjen e tyre, bashkë me Perandorinë Ruse.

Cfarë duhet të bëjë Europa për ta rimarrë veten?

E di që jam kundër rrymës, por duhet të jetë më elastike, më solidare dhe më pragmatiste, duhet të përparojë më gradualisht drejt integritetit. Protesta popullore kundër establishment-it europian, politika dhe partitë duhet të kontrollohen, sepse ushqejnë shumë nacionalizmat. Europeanët kanë një trashëgimi të përbashkët, që me kalimin e kohës do i lejojë të arrijnë shumë objektiva.

Historianë të tjerë, Francis Fukuyama me librin “Rendi politik dhe rënia politike” dhe Niall Ferguson me “Rënia e madhe”, kanë kaluar nga triumfalizmi, tek rënia, amerikane dhe perëndimore...

Është një debat i destinuar të intensifikohet. Triumfalizmi ishte një pasojë e shpërbërjes së BRSS dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë. Faktorët e rënies janë të shumtë, dhe ndoshta i pari është shkak i situatës së Islamit. Nuk kam menduar asnjëherë që Pranvera Arabe do të sillte menjëherë demokracinë, duhen disa breza që demokracia të lulëzojë. Por nuk imagjinoja kurrë një situatë si kjo, e cila arrin t'i shpëtojë çdo kontrolli.

Ju i konsideroni problemet e botës arabe dhe myslimane, një rrezik më të madh se sa tensionin në rritje mes Rusisë dhe Amerikës në Ukrainë?

Po. Putini e di që nuk mund të shkelë të gjithë rregullat ndërkombëtare, i njeh limitet e fuqisë së vendit të tij dhe ka telashet e tij politike dhe ekonomike. Islami përjeton konvulsione të tillë, që përbëjnë një element destabilizues për Perëndimin.

Libri juaj bestseller, “Ngjitja dhe rënia e fuqive të mëdha” është botuar 25 vjet më parë. Kemi mësuar që po përgatisni një rishikim të tij. Cfarë ndryshimesh do të bëni?

Ende nuk e kam vendosur, do të duhet të punoj për një vit. Në krahasim me vitet Tetëdhjetë, globalizimi ka ndryshuar gjithçka, nuk ka më BRSS, Japonia ia ka lënë vendin Kinës, Islami është një e panjohur. Nuk besoj se rendi botëror që u krijua pas 1945-ës do të mbijetojë në përjetësi. Por, e përsëris, kjo nuk do të thotë se Perëndimi do të bëhet dytësor, gjithmonë nëse nuk do të ketë ngjarje të paparashikueshme. Pa dyshim, qytetërimi



lindor është në ngjitje, dhe një ditë mund të rimarrë pozicionin që qytetërimi perëndimor ia “rrëmbeu” katër apo pesë shekuj më parë. Por kjo do të ndodhte vetëm nëse Perëndimi, dhe mbi të gjitha Amerika, do të hiqte dorë nga lidershpi. /PBS/

*** Paul Michael Kennedy është historian britanik në Yale University, i specializuar në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, fuqive ekonomike dhe strategjive të mëdha.**



Katër arsye përse politika e jashtme e BE fle gjumë

JAN TECHAU

BE vuan prej problemeve të identitetit, institucioneve të dobët, një “bariu” të jashtëm të munguar dhe mungesës së përkushtimit të tre liderëve të brendshëm. Kur bashkohen këto katër mangësi, shfaqet një përzierje e shkaqeve që qëndrojnë në themel të sklerozës europiane në politikën e jashtme. Nuk është habi që, aktorët e jashtëm që pëlqejnë të shfrytëzojnë dobësinë e perëndimit, mendojnë se Europa është një forcë e shuar

Probleme të jashtëm kolosale po shfaqen përpara Europës. E megjithatë, ka shumë pak shenja që 28 shtetet që formojnë Bashkimin European do të fillojnë të veprojnë së afërmi, për kërcënimet dhe interesat e përbashkët, në një mënyrë më të bashkuar dhe më me forcë.

Disa fajësojnë politikën e kursimit për këtë mosveprim. Të tjerë thonë se Bashkimi European nuk është krijuar asnjëherë për të bërë politikë të jashtëm. Megjithatë, të tjerë thonë se europianët janë thjeshtë naivë, njerëz që

Cështjet e sigurisë për të cilat flasin aq shumë analistët kanë një rëndësi dytësore për njerëzit e zakonshëm. Dhe nëse njerëzit e zakonshëm nuk janë shumë të shqetësuar, politikanët kanë prirjen të mos e hapin atë "kanaçe me krimba". Kjo është veçanërisht e vërtetë, nëse kjo kanaçe me krimba nënkupton ndërtimin e një reagimi të bashkuar paneuropian, apo peshimin e mundësisë së rritjes së shpenzimeve ushtarake

kapen pas dëshirave dhe ideve të thjeshtësuara në lidhje me mënyrën se si funksionon bota.

Asnjë prej këtyre nuk është e vërtetë. Arsytet përse politika e jashtme europiane fle gjumë janë shumë më të thella. Janë katë faktorët themelorë: identitetet, institucionet, neglizhimi i jashtëm dhe mosinteresi i brendshëm.

Identitete të kërcënuar?

Së pari, europianët mendojnë se rreziku ndaj identiteteve të tyre kombëtarë është tani më i madh se sa rreziku ndaj sigurisë së tyre fizike. Shikoni mirë se çfarë diskutojnë me të vërtetë njerëzit jashtë faqeve të editorialëve të gazetave të mëdha, dhe gjasat janë që të ngatërroheni në debate për imigrimin e paligjshëm, islamizimin, krimet që kryejnë të huajt, kultura e brendshme që ndryshon dhe bëhet e panjohëshme, paratë e taksapaguesve që harxhohen për njerëz që janë shumë larg, e kështu me radhë.

Këto tema dominojnë ligjërimin politik në tre vendet më të mëdhenj të BE-së – Gjermani, Francë dhe Britani – si dhe në një pjesë të madhe të shteteve të tjerë, duke përfshirë Austrinë, Holandën dhe Hungarinë.

Debatet e nxitur prej identitetit kanë prirjen t'i prekin njerëzit në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe shumë më emocionalisht se sa çështjet në dukje abstrakte, si rreziku që paraqet Rusia ndaj rendit politik europian, rreziku i të ashtuquajturit Shteti Islamik ndaj stabilitetit në Lindjen e Mesme, sfida që Kina paraqet për ekuilibrin global të fuqive, ose ndjekja e programit bërthamor nga ana e Iranit.

Cështjet e sigurisë për të cilat flasin aq shumë analistët kanë një rëndësi dytësore për njerëzit e zakonshëm. Dhe nëse njerëzit e zakonshëm nuk janë shumë të shqetësuar, politikanët kanë prirjen të mos e hapin atë "kanaçe me krimba". Kjo është veçanërisht e vërtetë, nëse kjo kanaçe me krimba nënkupton ndërtimin e një reagimi të bashkuar paneuropian, apo peshimin e mundësisë së rritjes së shpenzimeve ushtarake.

Institucione të papërshtatshëm

Arsyeja e dytë për ngathtësinë e Europës është se nuk ka një institucion të vetëm, që të mundet të formulojë në mënyrë të besueshme një interes të përbashkët europian. Pro integracionistët kanë prirjen të besojnë se ose Komisioni Europian, ose Parlamenti Europian janë të aftë për këtë detyrë. Por në fakt, asnjëri nuk është.

Pjesë të komisionit i afrohen shumë idealit të të qënurit avokatër të një interesi të përbashkët europian. Por këto janë degë të ekzekutivit të BE-së që mbrojnë interesa të përbashkët për çështje si tregtia apo tregu i përbashkët, teksa asnjëra prej këtyre të dyjave nuk është në qendër të politikës së jashtme klasike.

Ai krah i komisionit që njëherë arriti të promovojë një linjë të përbashkët të BE-së për çështjet e jashtme është transformuar në Shërbimin e Vepimeve të Jashtëm të BE. Por deri tani, ky organ ka qenë shumë i pafuqishëm, shumë i kontrolluar prej shteteve anëtarë, dhe shumë i keqmenaxhuar, për të qenë pararojë e lidershit të politikës së jashtme të BE-së. Sa për Parlamentin Europian, ai nuk përfaqëson vullnetin e unifikuar politik të një politike europiane – pavarësisht përpjekjeve të tij të dëshpëruara për të bërë pikërisht këtë gjë. Shpesh herë, pozicionet e Parlamentit paraqesin diçka më shumë se sa këndvështrimin e anëtarëve të tij, një kastë e veçantë europolitikane që kanë një pozicion të sikletshëm mes mandateve të tyre të ngushtë kombëtarë, fodullëkut europian dhe mungesës strukturore të llogaridhënies.

Në teori, fokusi i madh që Parlamenti Europian ka tek vlerat dhe parimet është një gjë e mirë. Por, në një kohë kur ky theks nuk shoqërohet me botën më realiste të vendim-marrjes ekzekutive, ai shpesh herë përfundon si shfaqje morale prej tribunave.

Institucioni më i prirur për të "farkëtuar" diçka që i ngjan një interesi të përbashkët të BE është Këshilli i Bashkimit Europian. Si përfaqësues i qeverive të shteteve anëtarë, këshilli ka mandatin më të fortë demokratik

Kufizimi i tretë në veprimin e jashtëm të BE është ndryshimi i rolit të SHBA. Uashingtoni është më pak i interesuar për Europën, se sa ka qenë, e si pasojë bën më pak presion ndaj Europës që "të mbledhë mendjen". Arritja më e madhe në politikën e jashtme të Europës gjatë pesë viteve të fundit ka qenë uniteti i saj i paprecedentë dhe jetëgjatë për sanksionet kundër Iranit, për shkak të programit bërthamor të këtij vendi

nga të gjithë institucionet e Brukselit. Por, pjesëtarët e këtij organi, ruajnë gjithashtu me xhelozë privilegjet kombëtarë në politikën e jashtme, dhe si pasojë shpesh herë nuk arrijnë në kompromise që janë të domosdoshëm për t'i mbijetuar kontaktit të parë me botën reale.

Në mungesë të një institucioni që do të mundej të formulonte në mënyrë të besueshme dhe domethënëse një politikë të jashtme paneuropiane, veprimi i BE jashtë do të mbetet jo i bashkuar, i dobët dhe, me disa përjashtime, përgjithësisht jo mbresëlënëse.

SHBA e shkëputur

Kufizimi i tretë në veprimin e jashtëm të BE është ndryshimi i rolit të SHBA. Uashingtoni është më pak i interesuar për Europën, se sa ka qenë, e si pasojë bën më pak presion ndaj Europës që "të mbledhë mendjen". Arritja më e madhe në politikën e jashtme të Europës gjatë pesë viteve të fundit ka qenë uniteti i saj i paprecedentë dhe jetëgjatë për sanksionet kundër Iranit, për shkak të programit bërthamor të këtij vendi. Por prapa këtij uniteti ka një sekret të vogël e të pistë: një trysni e madhe e SHBA ndaj europianëve, duke përfshirë edhe trysninë rregullatore nga agjencitë e qeverisë së SHBA ndaj kompanive europiane që bëjnë biznes me Teheranin. Është një e vërtetë përgjithësisht e padeklaruar se veprimtaria e politikës së jashtme të BE shpesh herë mbështetet në udhëheqjen e SHBA. Kjo është e vërtetë në Ballkan, në Afganistan, në shumicën e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes dhe më së fundmi, në luftën kundër Shtetit Islamik. Amerika ka qenë shtytësi, kufizuesi, konceptuesi dhe pajisësi i politikës së jashtme të BE-së. Ajo ka qenë gjithashtu siguresi i besimit për europianët, duke garantuar që asnjë vend i BE nuk do të bëhet shumë dominues në çështjet e jashtme të kontinentit, duke i eliminuar kështu tensionet potenciale që në krye të herës.

Por këto kohë, ky lloj lidërsipëri i SHBA është i rrallë dhe shpesh vjen me gjysmë zemre, duke e zbritur edhe më shumë nivelin e energjisë së BE në politikën e jashtme.


Tre të mëdhenjtë jo ambiciozë

Faktori i katërt që qëndron prapa letargjisë së BE-së është fakti që tre shtetet më të mëdhenj të unionit kanë frenuar investimet e nevojshëm në politikën e jashtme të BE.

Britania është e interesuar në disa pjesë të politikës së jashtme të BE, por i mungon mbështetja për integrimin europian që do të mund ta bënte këtë vend një lider. Franca bën sikur shfaq një interes, por pengohet prej periudhave jorealiste të krenarisë kombëtare si dhe kredibilitetit dhe burimeve të pakësuar. Gjermania, teorikisht, i ka burimet por vuan prej një kombinimi të pasivitetit tradicional, orekseve njëpalësh të sapozbuluar, dhe një droje ushtarake që e redukton shumë ndikimin e saj.

BE vuan prej problemeve të identitetit, institucioneve të dobët, një "barriu" të jashtëm të munguar dhe mungesës së përkushtimit të tre liderëve të brendshëm. Kur bashkohen këto katër mangësi, shfaqet një përzjerje e shkaqeve që qëndrojnë në themel të sklerozës europiane në politikën e jashtme. Nuk është habi që aktorët e jashtëm që pëlqejnë të shfrytëzojnë dobësinë e perëndimit, mendojnë se Europa është një forcë e shuar. / Carnegie Europe/

** Jan Techau është drejtor i Carnegie Europe. Ai punon për integrimin e BE dhe politikën e jashtme, çështjet transatlantike si dhe politikën e jashtme dhe të sigurisë të Gjermanisë*



Bërthamorja është kthyer mbi tryezë

GIDEON RACHMAN

Brezi i prindërve të mi u mësua të jetojë nën hijen e bombës. Por për brezin tim, vetë ideja e luftës bërthamore tingëllon si diçka që i përket fantashkencës, apo edhe komedisë së zezë, si për shembull “Dr. Strangelove”. Por arsenalët bërthamorë të botës nuk u eliminuan pas Luftës së Ftohtë. Fatkeqësisht, mund të jemi duke u kthyer në një kohë kur rreziku i armëve bërthamore nuk mund të trajtohet më si thjeshtë material për fantashkencë

Asnjëherë nuk kisha kohë për gratë e Greenham Common. Si një student reaksionar në vitet 1980, i konsideroja ato – dhe protestën e tyre para një baze britanike armësh bërthamore – si marrëzi dhe të gabuar. Në fund të fundit, disa dekada eksperiencë na kishin mësuar se strategjia e përmbytjes bërthamore funksiononte.

Tridhjetë vjet më vonë, paqja bërthamore ende “mban”. Por, tani po bëhet më pak i sigurtë që, armët bërthamore nuk do të përdoren asnjëherë.

Duket se Putini po përdor atë që Richard Nixoni e quante “teoria e lidershit të çmendur”. Ish presidenti i SHBA e shpjegonte kështu: “Nëse kundërshtari ndien që ti je i paparashikueshëm, qoftë edhe i nxituar, ai do të frenohet dhe nuk do të të shtyjë më shumë. Shanset që ai të ndalet rriten shumë”. Presidenti Putin mund të ketë të drejtë kur llogarit që, duke vendosur armën bërthamore mbi tryezë, ai mund të shfaqet gjithmonë si “më i çmendur” se Obama, Presidenti racional dhe i ftohtë i SHBA

Ka tre arsye për ankthin tim. Së pari, përhapja e armëve bërthamore në vende të paqëndrueshëm si Pakistani dhe Korea e Veriut. Së dyti, shtimi i provave që tregojnë se sa shpesh ka qenë bota, në kohë të ndryshme, pranë konfliktit bërthamor. Arsyeja ime e tretë për t’u shqetësuar është pak më e menjëhershme: një rritje domethënëse e kërcënimeve bërthamore nga Rusia.

Si privatisht, edhe publikisht, rusët janë duke përmendur tashmë në mënyra gjithmonë e më eksplicite, arsenalin bërthamor të vendit të tyre. Pak javë më parë, isha dëshmitar kur një rus i njohur paralajmëroi audiencën, gjatë një seminari privat në Uashington, se “Presidenti Putin e ka vendosur armën bërthamore mbi tryezë”. Është e vërtetë që presidenti rus i është drejtuar një audience në vendin e tij se të huajt nuk duhet të “kërkojnë belanë” me ne, sepse “Rusia është një prej fuqive kryesore bërthamore”.

Javën që kaloi, Pravda – “altoparlanti” sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë – kishte një artikull me titullin: “Rusia përgatit surprizën bërthamore për NATO-n”. Në të, krenohet se Rusia kishte barazi me SHBA sa i përket armëve bërthamore strategjike, dhe më tej mburret: “Sa për armët bërthamore taktike, superioriteti i Rusisë moderne ndaj NATO-s është edhe më i madh. Amerikanët janë të vetëdijshëm për këtë. Më parë, ata ishin të bindur se Rusia nuk do të rritej kurrë më. Tani është shumë vonë”.

I vetmi hezitim i imi kur shkruaj për këtë temë është se kam pak dyshime që një prej qëllimeve të kësaj “fryrjeje” bërthamore nga Moska është pikërisht që të bëjë që komentatorët perëndimorë të flasin për një rrezik bërthamor nga Rusia. Rusia dëshiron shumë që Perëndimi të ndalë furnizimin me armë të Ukrainës. Kështu që, ata duan të përçojnë mesazhin se çdo përshkallëzim i tillë do të provokonte një reagim nga Moska dhe – ku i dihet – ndoshta edhe përdorimin e armëve bërthamore.

Duket se Putini po përdor atë që Richard Nixoni e quante “teoria e lidershit të çmendur”. Ish presidenti i SHBA e shpjegonte kështu: “Nëse kundërshtari ndien që ti je i paparashikueshëm, qoftë edhe i nxituar, ai do të frenohet dhe nuk do të të shtyjë më shumë. Shanset që ai të ndalet rriten shumë”. Presidenti Putin mund të ketë të drejtë kur llogarit që, duke vendosur armën bërthamore mbi tryezë, ai mund të shfaqet gjithmonë si “më i çmendur” se Obama, Presidenti racional dhe i ftohtë i SHBA.

Megjithëkëtë, edhe nëse supozojmë se gjithë këta zëra për armë bërthamore nga Rusia janë bllof, është sërish e rrezikshme – përderisa për ta bërë bllofin sa më kanosës, rusëve u duhet të rrisin tensionet dhe të ndërmarrin risqe. Javën që kaloi, Gjenerali Philip Breedlove, komandant i forcave të NATO-s në Europë, tha se Rusia “kishte zhvendosur forca që mund të jenë edhe bërthamore” në Krime. Teksa luftimet në Ukrainë vazhdojnë, rreziku që Rusia dhe NATO të keqkuptojnë qëllimet e njëra-tjetrës sa vijnë dhe rriten.

Historianët e Luftës së Ftohtë kanë treguar se gabimet dhe llogaritë e gabuara e kanë çuar botën pranë luftës aksidentale bërthamore, më shpesh nga sa mund të kemi ne dijeni. Një raport i kohëve të fundit i Institutit Mbretëror të Britanisë për Marrëdhëniet me Jashtë, me titull “Shumë pranë për t’u ndijerë të qetë”, dokumenton disa incidente. Disa prej tyre përfshinin defekte kompjuterikë, që çuan ose SHBA, ose BS të mendonin se ishin të sulmuar. Në raport thuhet: “Vendim-marrja individuale, shpesh herë në mosbindje të protokollit dhe udhëheqjes politike, në disa raste ka sjellë shmangien e katastrofës”.

Shumë prej këtyre aksidenteve kanë ndodhur gjatë periudhave me një tension politik të lartë mes Moskës dhe Uashingtonit. Më i famshmi i tyre ishte ai i Krizës së Raketave në Kubë në vitin 1962. Një shembull më i vonë – me një jehonë të fortë sot – ishte incidenti i Able Archer në nëntor 1983.

Në shtator të atij viti, Bashkimi Sovjetik kishte rrëzuar një avion civil të Korean Air, duke shkaktuar vdekjen e 267 vetëve. Ajo tragjedi, ashtu sikurse rrëzimi i Malaysian Airlines M17 mbi Ukrainë këtë vit kishte rritur

shumë tensionet lindje-perëndim, ndërkohë që rusët, ashtu si edhe sot, akuzonin Amerikën për militarizëm dhe plane për dominim të botës.

Në këtë sfond, NATO organizoi një stërvitje ushtarake, ku simuloi një sulm bërthamor të Perëndimit ndaj BRSS. Operacioni “Abble Archer” ishte kaq realist, saqë shumëkush në Moskë e interpretoi si një përgatitje për një sulm të NATO-s. Rusët bënë gati armët e tyre bërthamore. Duket se shërbimet e fshehtë lajmëruan menjëherë perëndimin, për mënyrën se si po shihej në Moskë operacioni, dhe gjithçka u zbut.

Një mësim nga ai episod është se ekzistenca e “hotline” (linjës së posaçme telefonike) mes Moskës dhe Uashingtonit, nuk është garanci që dy palët nuk do të bëjnë “proçka”. Një tjetër mësim është se, çdo lloj lëvizje e paqartë, e cila përfshin armët bërthamore, mund të shkaktojë një panik të rrezikshëm.

Brezi i prindërve të mi u mësua të jetojë nën hijen e bombës. Por për brezin tim, vetë ideja e luftës bërthamore tingëllon si diçka që i përket fantashkencës, apo edhe komedisë së zezë, si për shembull “Dr. Strangelove”. Por arsenalët bërthamorë të botës nuk u eliminuan pas Luftës së Ftohtë. Fatkeqësisht, mund të jemi duke u kthyer në një kohë kur rreziku i armëve bërthamore nuk mund të trajtohet më si thjeshtë material për fantashkencë./FT/



Ky njeri është një ishull

DAVID ROTHKOPF

Pas zgjedhjeve të të martës, Presidenti i SHBA, Barack Obama, është një figurë e vetmuar. Në fakt, ai mund ta përfundojë mandatin e tij, si presidenti më i izoluar që ka pasur Amerika, që nga koha e Richard Nixonit. Nëse ndodh, është një telash që ia ka krijuar vetë vetes. Izolimi fillon me faktin që, qysh në krye të herës, për presidentin dhe ekipin e fushatës së tij nuk bëhej gjithçka për Partinë Demokratike. Nuk bëhej gjithçka për pjesën tjetër të ekipit të atyre në administratë. Nuk bëhej gjithçka për rrjetin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Që në krye të herës, gjithçka bëhej vetëm për një njeri, i cili ishte produkti, mesazheri, misioni dhe arsyeja e ekzistencës, të cila të mbështjella në një të vetme. Dhe për dy vitet e ardhshëm, Obama do të korrë frytet e narcizizmit të tij politik në një mënyrë që do të jetë e vështirë jo vetëm për atë vetë, por do të jetë e keqe edhe për Amerikën dhe rolin e saj në botë. Humbjet e rënda të Partisë Demokratike në Senat, Kongres dhe në zgjedhjet për guvernatorë në të gjithë Amerikën ishin jo vetëm shembulli më i fundit i një modeli historik të përsëritur të zgjedhjeve të mesit të mandatit. Për nga numri total i vendeve që kaluan në anën e opozitës, ato përbëjnë një prej humbjeve më të rënda të të gjitha kohërave, për një parti prej të

Ndërkohë që presidentët me dy mandate si Bushi 43, Clintoni dhe Reagani të gjithë e përfunduan kohën e tyre në Shtëpinë e Bardhë si më të fortë në politikën e jashtme në krahasim me fillimet, kjo duket se nuk do të ndodhë me Obamën – pavarësisht faktit se të tre paraardhësit e tij, ashtu si Obama, ishin të dobësuar prej politikës së brendshme si dhe faktorë të tjerë, teksa përfundonin çerekun e katërt të mandateve të tyre. Pjesërisht, kjo vjen prej faktit se humbjet e Demokratëve të martën ishin shumë të rënda

cilës ka dalë presidenti në detyrë. Dhe ndërkohë që ishin, pjesërisht, një mospranim i statusquo-së jofunksionale në Uashington, ato ishin, në thelb, edhe një mospranim ndaj Presidentit.

Ndërkohë që disa do të thonë se këto zgjedhje nuk kishin aspak të bënin me të metat e mëdha të politikës së jashtme të Obamës, këta persona injorojnë në një masë të madhe se sa shumë e kanë dëmtuar perceptimin që ka publiku për Obamën, gabimet e tij në skenën ndërkombëtare.

Duke lënë mënjane debatet individuale për zgjedhjet e politikave, publiku dëshiron që Amerika dhe udhëheqësit e saj të jenë të fortë. Në Krime apo në Siri, në Irak apo në Afganistan, në grindjet me aleatët apo në manipulimin prej rivalëve, Obama nuk ka projektuar aspak një imazh të tillë. Dobësia dhe mungesa e efikasitetit të tij në politikën e jashtme pa dyshim që kanë luajtur një rol në këtë rezultat. Dhe prandaj, janë një arsye përse në dy vitet e ardhshëm, me shumë gjasë do të shohim një Amerikë e cila ngjan shumë me presidentin e saj, gjithnjë e më joefikase ndërkombëtarisht – teksa bota pret pasardhësin e tij dhe shpreson për një ndryshim në karakterin e udhëheqjes së SHBA.

Ndërkohë që presidentët me dy mandate si Bushi 43, Clintoni dhe Reagani të gjithë e përfunduan kohën e tyre në Shtëpinë e Bardhë si më të fortë në politikën e jashtme në krahasim me fillimet, kjo duket se nuk do të ndodhë me Obamën – pavarësisht faktit se të tre paraardhësit e tij, ashtu si Obama, ishin të dobësuar prej politikës së brendshme si dhe faktorë të tjerë, teksa përfundonin çerekun e katërt të mandateve të tyre. Pjesërisht, kjo vjen prej faktit se humbjet e Demokratëve të martën ishin shumë të rënda. Pjesërisht vjen prej faktit se Obama dhe rrethi i tij i ngushtë, shihen brenda partisë së tij, si shkak i kësaj humbjeje të rëndë. Jo vetëm duhej fajësuar Obama për atë që ka bërë si President, por sërish, ashtu si në 2012-ën dhe 2010-ën, mungesa e mbështetjes energjike të tij për kandidatët e partisë që i përket ka ushqyer një farë armiqësie. Një ilustrim i tillë është dhe komenti që ka bërë për Uashington Post shefi i Kabinetit i udhëheqësit në largim të shumicës së demokrateve në Senat, Harry Reid, i cili tha: “Nuk mendoj se ekipi politik në Shtëpinë e Bardhë kishte shpejtësinë e duhur dhe vullnetin e duhur për të bërë atë që duhej bërë” dhe “përqindja e mbështetjes popullore për presidentin nuk është as 40%. Cfarë mund të thuash më shumë?”

Me mendime të tillë që, jo vetëm ekzistojnë, por edhe shprehen publikisht, me shumë gjasë presidenti do ta ketë tejet të vështirë të sigurojë ndonjë mbështetje politike për çështjet e brendshme, qoftë edhe nga njerëz që mendohej se duhej ta jepnin atë. Shpresat e tij më të mëdha janë që të çojë përpara çështje ku agenda e Partisë Republikane dhe e tija përputhen, si përshembull marrëveshje transatlantike për tregtinë, reforma e taksës mbi fitimin, apo projektet infrastrukturorë.

Por për një sërë çështjesh të tjera, duke përfshirë edhe për të fituar mbështetjen për shumë prej nismave të tij në politikën e jashtme (dhe shmangien e pengesave për të tjerat, si marrëveshje për programin bërthamor të Iranit), ky do të jetë një president në kundërshtim edhe me Senatin, edhe me Kongresin dhe një që nuk është në gjendje të sigurojë mbështetje. Por, kjo gjë do u dërgojë një mesazh aleatëve dhe rivalëve në të gjithë botën, se presidenti nuk do të jetë domosdoshmërisht në gjendje të mbajë premtimet që mund të bëjnë ai, apo ekipi i tij.

Sjellja e tij në të kaluarën dhe pasojat e saj me shumë gjasë do e bëjnë më kompleks dobësimin e tij të brendshëm. Ky nuk është një president si Bushi, apo Clintoni, apo Reagani që të ketë një rrjet udhëheqësish të huaj, që të jenë miq të singertë, të cilët i besojnë atij, dhe me të cilët ai ka ndërtuar marrëdhënie të rëndësishme. I ftohtë me partinë e tij dhe të emëruarit e kabinetit në Amerikë, marrëdhëniet e Obamës me udhëheqësit ndërkombëtarë kanë qenë gjithmonë të ftohta dhe në disa raste (si ato marrëdhënie të rëndësishme me Erdoganin në Turqi apo Netanjahun në Izrael) janë përkeqësuar shumë. (Dhe le ta themi: nuk të ndihmon shumë kur pjesëtarë

*Merrni pa-
rasysh gjithë
këta faktorë dhe
peisazhi i pre-
sidentit i ngjan
shumë filmit
të famshëm
(Rikthim në të
Ardhmen), ku
para syve tanë
mund të shohim
imazhin e tij që
zbërdhulet drejt
hiçit. Në atë
film, e vetmja
mënyrë për të
kthyer mbrapsht
procesin është
që të rikthehet
historia në ren-
din e saj fillestar.
Për Obamën, e
vetmja mënyrë
për ta bërë do të
jetë që të zhbëjë
formulën që
ka në kokë dhe
bashkë me të të
zhbëjë historinë
e izolimit të
vetvetes*

të stafit tënd i quajnë aleatët “glasa”). Për një njeri të tillë, organizimi i koalicioneve ndërkombëtarë që të arrijnë rezultate domethënës do të jetë shumë i vështirë, edhe pse sekretari i tij i shtetit përpiket pafundësisht për ta bërë. Ndonjëherë duhet prekja e presidentit. Por ky president, që garoi në vitin 2008 me një politikë angazhimi me shumë gjasa do të hyjë në histori si praktikuesi i “mosangazhimit serial”, ndonjëherë si rezultat i vendimeve politike të qëllimshëm, ndonjëherë si rezultat i një mungese gatishmërie për të bërë punën që nevojitet për të menaxhuar dhe ruajtur marrëdhënie jetike.

Shtojini gjithë sa u thanë më sipër, edhe faktin që gjërat nuk po shkojnë shumë mirë për një sërë prej përpjekjeve më të rëndësishme ndërkombëtare të Obamës – rritjen e tensioneve me Rusinë (mbani vesh Gjeorgjinë, vendet balltike dhe ekonominë e Rusisë teksa çmimet e naftës po bien), Siri dhe Irak (ku na mungon një strategji koherente apo angazhimi ushtarak për të bërë punët që kemi premtuar), Libi (sot në flakë), Izrael-Palestinë (tensionet po rriten), në Afganistan (ku askush nuk beson se arrijtet politike të kohëve të fundit do të jenë jetëgjata dhe ku talebanët janë vënë në lëvizje), apo gjetkë.

Merrni parasysh gjithë këta faktorë dhe peisazhi i presidentit i ngjan shumë filmit të famshëm (Rikthim në të Ardhmen), ku para syve tanë mund të shohim imazhin e tij që zbërdhulet drejt hiçit. Në atë film, e vetmja mënyrë për të kthyer mbrapsht procesin është që të rikthehet historia në rendin e saj fillestar. Për Obamën, e vetmja mënyrë për ta bërë do të jetë që të zhbëjë formulën që ka në kokë dhe bashkë me të të zhbëjë historinë e izolimit të vetvetes, nga ata prej të cilëve të gjithë presidentët duhet të varren për suksesin ndërkombëtar – aleatët politikë në vend, pjesëtarë të ekipit të tij që kanë vërtetë nevojë për mbështetje me qëllim që të menaxhojnë problemet e njëkohshëm, si dhe homologët e tij përreth botës. Përndryshe, në dy vitet e ardhshëm do ta shohim botën si një tablo ku ka shumë fytyra të njohura, dhe një hapësirë boshe, aty ku dikur zinte vend presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. /Foreign Policy/



Frojdi dhe Lindja e Mesme

THOMAS L. FRIEDMAN

Kur përpiqemi t'i japim kuptim asaj që ndodh në Lindjen e Mesme, një prej rregullave më të rëndësishëm që duhet të mbajmë parasysh është ky: Ajo që politikanët këtu ta thonë privatisht, zakonisht është pa lidhje. Ajo që ka më shumë rëndësi, dhe ajo që shpjegon më së miri sjelljen e tyre, është çfarë i thonë publikisht, në gjuhën e tyre, popullit të tyre. Ndërkohë që presidenti Obama dërgon më shumë këshilltarë për të ndihmuar irakenët që të mundin Shtetin Islamik, është shumë e rëndësishme që të dëgjojmë me kujdes se çfarë thonë publikisht aktorët kryesorë, në gjuhën e tyre, në lidhje me njëri-tjetrin dhe aspiratat që kanë.

Për shembull, Instituti Kërkimor i Mediave i Lindjes së Mesme, ose Memri, kohët e fundit postoi një pjesë të një interviste të dhënë nga Mohammad Sadeq al-Hosseini, një ish këshilltar i presidentit të Iranit, Mohammad Khatami, e cila ishte transmetuar në TV Mayadeen në 24 shtator, ku ai thoshte se Irani shiit, përmes të tretëve, ka marrë kontrollin de facto të katër kryeqyteteve arabë: Beirutit, përmes militantëve shiitë të Hezbollahut; Damaskun, përmes regjimit shiit/alavit të Bashar al-Assadit; Bagdadin, përmes qeverisë së kryesuar nga shiitët atje; dhe – për këtë shumë pak vetë në Perëndim e kishin mendjen – Sanan, ku sekti shiit jemenas pro iranian, Houthi, kohët e fundit mori kontrollin e kryeqytetit të Jemenit dhe tani dominon mbi sunitët. Al Hosseini tha për Iranin dhe aleatët e tij: “Ne, në boshtin e rezistencës, jemi sulltanët e rinj të Mesdheut dhe Gjirit. Ne

Për ta përmbledhur, ka kaq shumë ëndrra dhe makthe që bien ndesh mes tyre, në mendjet e aleatëve të SHBA kundër ISIS-it në Lindjen e Mesme, sa që edhe Frojdi nuk do të kish qenë në gjendje të vinte rregull. Po të dëgjoni me vëmendje, nga këto ëndrra, ajo e jona – pra demokracia pluraliste – nuk është në krye të listës. Në Lindjen e Mesme ne duhet të mbrojmë ishujt e “mirësisë” – Jordaninë, Kurdistanin, Libanin, Abu Dhabin, Dubain, Omanin – nga ISIS-i, me shpresën që shembujt e tyre më të mirë një ditë do të mund të përhapen

në Teheran, Damask, në periferinë jugore të Beirutit, Bagdad dhe Sana do të ribëjmë hartën e rajonit. Ne jemi gjithashtu sulltanët e rinj të Detit të Kuq”. Dhe ai shtoi se, Arabia Saudite është një “tribu në prag të zhdukjes”. Ne mund të mos i dëgjojmë këto gjëra, por arabët sunitë i dëgjojnë, sidomos tani kur SHBA dhe Irani mund t’i japin fund luftës së tyre të ftohtë 35-vjeçare dhe arrijnë një marrëveshje që do i lejonte Iranit një program bërthamor “paqësor”. Kjo ndihmon për të shpjegur edhe diçka tjetër që mund t’ju ketë shpëtuar: militantë sunitë shkuan në një fshat saudit shiit, al-Dalvah në 3 nëntor dhe qëlluan për vdekje pesë shiitë sauditë gjatë një aktiviteti fetar. Të paktën presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan ndodhet në botën moderne. Jo, prisni pak, cili është emri që Erdogani dëshiron t’i vendosë urës më të re që po ndërton mbi Bosfor? Përgjigja: Ura e Sulltan Selimit. Selimi i Parë ishte një sulltan sunit turk që, në vitin 1514 sprapsi Perandorinë Perse të kohës së tij, të quajturit Safavidë. Pakica Alevi në Turqi, një sekt shiit paraardhësit e të cilës u përballën me zemërimin e Selimit, ka protestuar për emrin e urës.

Ata e dinë që ai nuk ka dalë ashtu rastësisht. Sipas Enciklopedisë Britanica, Selimi I ishte sulltani Otoman (1512-20) që e shtriu perandorinë në Siri, Arabinë Saudite dhe Egjipt “dhe i ngriti myslimanët në udhëheqjen e botës myslimane”. Më tej, ai ktheu sytë nga lindja dhe iu kundërvu dinastisë shiite Safavide në Iran, e cila paraqiste një “rrezik politik dhe ideologjik” për hegjemoninë e Islamit sunit otoman. Selimi ishte i pari udhëheqës turk që shpalli se ishte njëkohësisht sulltan i Perandorisë Otomane dhe kalif i të gjithë myslimanëve. Zëvendëspresidenti Joe Biden nuk fliste kot kur akuzonte Turqinë se po lehtësonte futjen e luftëtarëve të ISIS-it në Siri. Ashtu sikur ka nga pakëz “kolon izraelit” të Bregut Perëndimor në çdo izraelit, ashtu ka edhe nga pakëz ëndërr për kalifatin në çdo sunit. Disa analistë turq dyshojnë se Erdogani nuk ëndërron për ndërtimin e një demokracie pluraliste në Irak dhe Siri, por më shumë një kalifat modern sunit – jo të udhëhequr nga ISIS, por nga ai vetë. Deri atëherë, është e qartë se ai preferon më shumë ISIS-in në kufirin e tij, se sa një Kurdistan të pavarur.

Siç shkruante Shadi Hamid, i Qendrës për Politikën e Lindjes së Mesme në Brookings, në një artikull për The Atlantic me titull “Rrënjët e Joshjes së Shtetit Islamik”: “ISIS e merr forcën prej ideve që kanë një jehonë të fuqishme mes popullsisë me shumicë myslimane. Ata mund të mos bien dakord me interpretimin që i bën ISIS kalifatit, por ideja e një kalifati – entiteti politik historik që qeveriset prej ligjit dhe traditës islamike – është shumë e fuqishme”. Në fakt, vëren studiuesi i Lindjes së Mesme, Joseph Braude, shumica e arabëve sunitë në Egjipt, Siri dhe Gadishullin Arabik në fundin e shekullit 19 “ishin kundër kalifatit të udhëhequr nga Turqia, që e kishin përjetuar. Ata thonë se ajo ishte një lloj force pushtuese”. Ishin grupet islamike sunitë të shekullit 20, veçanërisht Vëllazëria Myslimane, që e ringjallën idenë, duke e idealizuar kalifatin si një reagim ndaj dobësisë së rajonit të tyre dhe “duke e futur në diskurin fetar”.

Për ta përmbledhur, ka kaq shumë ëndrra dhe makthe që bien ndesh mes tyre, në mendjet e aleatëve të SHBA kundër ISIS-it në Lindjen e Mesme, sa që edhe Frojdi nuk do të kish qenë në gjendje të vinte rregull. Po të dëgjoni me vëmendje, nga këto ëndrra, ajo e jona – pra demokracia pluraliste – nuk është në krye të listës. Në Lindjen e Mesme ne duhet të mbrojmë ishujt e “mirësisë” – Jordaninë, Kurdistanin, Libanin, Abu Dhabin, Dubain, Omanin – nga ISIS-i, me shpresën që shembujt e tyre më të mirë një ditë do të mund të përhapen. Por unë jam skeptik që aleatët tanë të copëtuar, me shumëllojshmërinë e ëndrrave të tyre, mund të bien dakord për marrëveshje të reja të ndarjes së pushtetit për Sirinë apo Irakun, edhe nëse ISIS do të mposhtej. New York Times



I pakorrigjueshmi Henry Kissinger

WALTER ISAACSON

Kur ishte bashkëautor i politikës së jashtme amerikane, në rolin e Këshilltarit për Sigurinë Kombëtare të Richard Nixonit dhe më pas Sekretar Shteti në fillimin e viteve shtatëdhjetë, Kissingeri arrinte të manipulonte levat e këtij sistemi me një mjeshtëri që do ta kishte magjepsur Metternichun. Duke lënë mënjanë dallimet ideologjike dhe të vlerave me Amerikën, ai i dha shtysë një politike çtensionimi me Bashkimin Sovjetik dhe ka favorizuar një politikë hapjeje kundrejt Kinës, për t'i vënë më pas njëri kundër tjetrit me qëllim krijimin e një ekuilibri trekëndor forcash

Kur Henry Kissingeri flet për rend botëror, dikush mund të krijojë përshtypjen që ai po jeton në një shekull paraardhës. Ndoshta i XVII-i. Nuk është rastësi që, duke filluar nga teza e tij e doktoraturës, e arritur në Harvard gjashtëdhjetë vjet më parë, ai ka përforcuar gjithmonë këtë ide, e lindur në vitin 1648 pas Paqes së Vestfalisë, e cila i dha fund luftës tridhjetë

Shokët e tij të shkollës në fakultetin e shkencave politike të Harvardit e dëshironin zgjedhjen e tij të argumentave. Bomba atomike, sipas tyre, e kishte ndryshuar thellësisht politikën ndërkombëtare. Dhe njëri prej tyre i sugjeroi, me "keqdashje", që të rregjistrohej në fakultetin e historisë. Edhe ne mbetemi të habitur përballë lajmit që Kissingeri, në moshën 91 vjeç, është rikthyer të "filtrorë" sistemi vestfalian, në librin e tij më të fundit, i gjashtëmbëdhjetë në 60 vite, me titullin e thjeshtë: "Rendi botëror. Respekt për sovranitetin?" Sa e çuditshme!

vjeçare. Që atëherë, sistemi ndërkombëtar evropian nuk ishte produkt i luftërave fetare dhe i spazmave të fundit të Perandorisë së Shenjtë Romake, por bazohej mbi shtete-kombe të pavarur, secili sovran në fushën fetare dhe në sfera të tjera, mbi territorin e vet. Asnjë shtet nuk do të ndërhynte në punët e brendshme të të tjerëve dhe rendi do të ruhej, në teori, prej statistëve të zotë, të ndjeshëm ndaj interesave kombëtarë dhe ruajtjes së një ekuilibri të fuqive.

Kissingeri, siç e ka kujtuar edhe ai vetë më vonë, kishte filluar të vlerësonte rendin pasi familja e tij ishte larguar nga Gjermania e Hitlerit në vitin 1938 dhe kishte shkuar në Nju Jork, ku ai u vetëdijësua se nuk kishte më nevojë për të kaluar rrugën, me qëllim që të keqtrajtohej prej të rinjve jo hebrenj. Dhe u bë një ndjekës i shkollës realiste, e cila i kundërvihej asaj idealiste, në fushën diplomatike, i bindur se një politikë e jashtme shumë e kushtëzuar prej parimeve moralë dhe prej një fryme kryqëzate mund të ishte e rrezikshme. "Problemi më i rëndësishëm për politikën", shkruante Kissingeri në tezën e tij të doktoraturës, "nuk është ai i shtypjes së impulseve të këqinj, por i mbajtjes nën fre të etjes për drejtësi".

Shokët e tij të shkollës në fakultetin e shkencave politike të Harvardit e dëshironin zgjedhjen e tij të argumentave. Bomba atomike, sipas tyre, e kishte ndryshuar thellësisht politikën ndërkombëtare. Dhe njëri prej tyre i sugjeroi, me "keqdashje", që të rregjistrohej në fakultetin e historisë. Edhe ne mbetemi të habitur përballë lajmit që Kissingeri, në moshën 91 vjeç, është rikthyer të "filtrorë" sistemi vestfalian, në librin e tij më të fundit, i gjashtëmbëdhjetë në 60 vite, me titullin e thjeshtë: "Rendi botëror. Respekt për sovranitetin?" Sa e çuditshme! Nuk ka dëgjuar asnjëherë që rreziqet e shfaqur tashmë nga të gjitha anët përshkojnë çfarëdolloj kufiri, që ne kemi detyrën humanitare të mbrojmë popullsitë e vendeve të dominuar prej regjimeve shtypës?

Pikërisht për këtë arsye kemi hequr dorë nga Realpolitika, në favor të një "Agjende të Lirisë" që përfshinte pushtimin e Irakut për përhapjen e demokracisë në Lindjen e Mesme, përmbysjen e qeverisë së Muamar Gadafit në Libi me motivacione humanitare dhe jemi përpjekur (të paktën deri kur u shfaq Shteti Islamik) të bëjmë të njëjtën gjë me Bashar Asadin në Siri. Ndoshta... por po të reflektosh me kujdes, likuidimi i sistemit vestfalian, braktisja e parimit të respektimit të sovranitetit dhe lejimi që idealizmi të mbyste realizmin, mbase nuk ka qenë një ide e mirë, në fund të fundit. Dhe nëse është kështu, atëherë libri i ri i Kissingerit nuk duket aspakt i kohës. SHBA do të bënin mirë të dëgjonin këshillën e tij për të korrigjuar idealizmin e tyre me një dozë të re realizmi. "Parimet vestfalianë janë sot e vetmja bazë përgjithësisht e pranuar e atij që mund ta konsiderojmë një rend botëror".

Libri i tij na udhëheq në një udhëtim të dobishëm dhe shumë interesant në historinë e botës, duke ndjekur linjën e kërkimit të rendit, nga Kardinali Richelieu dhe Metternich dhe Bismarck, nga ministri indian Kautilya i shekullit IV pas Krishtit, deri tek Sulltani otoman Sulejmani si dhe një seri presidentësh amerikanë, që fillon me Teddy Rooseveltin dhe Woodrow Wilsonin. Një histori që e ka kulmin në vendosjen e një rendi botëror të bazuar në shtetet-kombe sovranë në fundin e Luftës së Dytë Botërore. "Në mesin e shekullit XX", shkruan Kissingeri, "ky sistem ndërkombëtar ishte në fuqi në të gjithë kontinentet".

Kur ishte bashkëautor i politikës së jashtme amerikane, në rolin e Këshilltarit për Sigurinë Kombëtare të Richard Nixonit dhe më pas Sekretar Shteti në fillimin e viteve shtatëdhjetë, Kissingeri arrinte të manipulonte levat e këtij sistemi me një mjeshtëri që do ta kishte magjepsur Metternichun. Duke lënë mënjane dallimet ideologjike dhe të vlerave me Amerikën, ai i dha shtysë një politikë çtensionimi me Bashkimin Sovjetik dhe ka favorizuar një politikë hapjeje kundrejt Kinës, për t'i vënë më pas njëri kundër tjetrit me qëllim krijimin e një ekuilibri trekëndor forcash në avantazh të Shteteve të Bashkuara, që arritën kështu të ruajnë ndikimin e tyre pas

Ndonëse Kissingeri vë rregullisht theksin në rëndësinë e idealizmit në traditën amerikane, pothuajse gjithmonë ky konstatim pasohet nga një "por". "Amerika nuk do të ishte besnike ndaj vetvetes nëse do ta braktiste këtë idealizëm të thellë", pranon ai. "Por për të qenë efikasë, këto aspirata duhet të kundërbilancohen nga një analizë e ftohtë e aktorëve në lojë". Ky alternativim "po... por", ku theksi vihet gjithmonë tek "por"-i përshkon gjithë analizën e tij dhe gjallëron çdo kapitull të librit të tij

tërheqjes nga Vietnami.

Por kjo politikë realiste e bazuar mbi mbrojtjen e interesave strategjike kombëtarë është e vështirë të mbështetet në një demokraci e cila lartëson jashtëzakonshmërinë e saj morale. "SHBA kanë alternuar mbrojtjen e sistemit vestfalian, duke refuzuar kushtet e tij, të bazuar në parimet e ekuilibrit të forcave dhe mosndërrhyrjes në punët e brendshme të vendeve të tjerë, të konsideruar si imoralë dhe të vjetëruar", thotë Kissingeri. Dhe fakti që ai dhe Nixon nuk arritën as të gërvishtin dhe aq shumë idealizmin e rrënjësor në ADN-në e Amerikës, e ka bërë të pasigurtë mbështetjen popullore për politikën e tyre realiste. Kissingeri është sulmuar nga idealistët dhe mbi të gjitha nga neokonservatorët, si dhe antikomunistët e palëkundur të të djathtës. Dhe reagimi ndaj realizmit të tij kontribuoi në fitoret elektorale si të Jimmy Carterit, edhe të Ronald Reaganit.

Ndonëse Kissingeri vë rregullisht theksin në rëndësinë e idealizmit në traditën amerikane, pothuajse gjithmonë ky konstatim pasohet nga një "por". "Amerika nuk do të ishte besnike ndaj vetvetes nëse do ta braktiste këtë idealizëm të thellë", pranon ai. "Por për të qenë efikasë, këto aspirata duhet të kundërbilancohen nga një analizë e ftohtë e aktorëve në lojë". Ky alternativim "po... por", ku theksi vihet gjithmonë tek "por"-i përshkon gjithë analizën e tij dhe gjallëron çdo kapitull të librit të tij.

Nevoja për një realizëm të rinovuar, thotë Kissingeri në mënyrë bindëse, vlen mbi të gjitha për Lindjen e Mesme, ku xhihadistët kanë shkatërruar sistemin e shtetit-komb me aspiratën e tyre për një revolucion global të bazuar mbi vlerat fetare ekstremiste. Kjo kryengritje e rrezikshme është lehtësuar pjesërisht prej vendimeve të motivuar moralisht, por të dyshimtë strategjikisht të SHBA, në mbështetjen e një ndryshimi regjimi dhe vendosjen e një demokracie të llojit perëndimor në Irak, Libi, Egjipt, Afganistan dhe Siri.

Në rastin e Afganistanit, Kissingeri ka mbrojtur sulmin fillestar kundër al Kaedës dhe mbrojtësve të saj talebanë, por hedh një vështrim skeptik në retrospektivë, ndaj misionit më të gjerë që e pati fillimin në vitin 2003. "Objektivi parësor i amerikanëve dhe aleatëve të tyre u bë ai i "rindërtimit të Afganistanit" nëpërmjet një qeverie demokratike, pluraliste, transparente, autoriteti i të cilës duhej të pranohej në të gjithë vendin". Por kjo "ribërje radikale e historisë afgane" nuk ishte e mundur: "Asnjë institucion në historinë e Afganistanit apo cilëndo pjesë të këtij vendi nuk kishte ofruar një bazë mbi të cilën të ngrihej një projekt kaq i madh".

Edhe në rastin e Irakut, Kissingeri kishte mbështetur fillimisht ndërhyrjen për të përmbysur regjimin e Saddam Huseinit, por me një farë rezerve. "Kisha dyshime, që i kisha shprehur publikisht dhe në institucione zyrtarë, në lidhje me idenë e shtrirjes së këtij misioni drejt rindërtimit të plotë të vendit dhe për t'i ngarkuar një detyrë kaq të madhe".

George W. Bushit dhe administratës së tij i vë fajin për nisjen e kryqëzatave idealiste që injoronin realitetin në terren. Siç thoshte Bushi në një fjalim të vitit 2003, "demokracia irakene do të ketë sukses dhe kjo gjë do të



Libri i tij i fundit përmbillet me një shënim të ndryshëm, përlësie: një tipar që në pjesën më të madhe të karrierës së tij ka bërë gjoja sikur e ka patur. "Shumë kohë më parë, në rininë time, isha shumë mendjemadh, aq sa të mendoja që mund të shpjegoja "Domethënien e historisë". Sot e di që kjo duhet kërkuar, jo shpallur"

përhapë lajmin e mirë, nga Damasku në Teheran, se demokracia mund të jetë e ardhmja e çdo kombi". Por ky ideal nuk kishte baza realiste. "Tentativa e realizimit të vlerave amerikane përmes një pushtimi ushtarak të një pjese të botës, ku nuk kishte kurfarë rrënjësh historike e bëri përpjekjen amerikane në Irak të duket si mundimi i Sizifit".

Pavarësisht ndërhyrjeve kardiokirurgjikale të cilave iu nënshtrua këtë vit, Kissingeri, sot 91-vjeçar, është si një luan në një dimër të gjatë. 40 vjet pas postit të fundit qeveritar, është në mënyrë konstante i pranishëm në trenat e shpejtësisë së lartë që lidhin Nju Jorkun me Uashingtonin, si dhe kryen udhëtime të rregullt në Rusi dhe Kinë, ku pritët nga autoritetet më të lartë. Analizat e tij mbeten largpamëse. Pikërisht kur ishte mbërritur në "larjen e hesapeve" në lidhje me armët kimike të Sirisë vitin që kaloi, Kissingeri ishte për darkë në Nju Jork me disa ekspertë ushtarakë dhe të shërbimeve të fshehtë, që diskutonin mbi atë që mund të ndodhte. Parashikimi i tij ishte që Rusia do të ndërhynte menjëherë për të ofruar një zgjidhje të mundshme të problemit të këtyre armëve, që nga momenti kur Moska dhe Uashingtoni kishin një interes të përbashkët strategjik për të mos lejuar që të binin në duart e terroristëve. Dy javë më vonë, pikërisht kjo ndodhi. Ai thotë gjithashtu se ishte gabim që të shpallej përmbyssa e regjimit të Asadit një objektiv politik, pa ditur se nga çfarë do të zëvendësohej, sepse ndoshta kjo do të shkaktonte një luftë civile kaotike të dominuar nga forcat xhihadiste më radikale.

Për tezën e diplomës në vitin 1950, Kissingeri kishte zgjedhur si temë "Domethënia e historisë": 383 faqe kushtuar përpjekjes për të gjetur një lidhje mes filozofive të Immanuel Kantit, Osvald Spenglerit dhe Arnold Toynbees, duke përmendur edhe idetë e Kartezit, Dostojevskit, Hegelit, Humes, Sokratit dhe Spinozës. E gjitha shoqërohej edhe nga një kapitull me titullin: "Një shtytje nga poezia", ku i referohej Dantes, Homerit, Virgjilit dhe Miltonit. Dhe në një pikë të caktuar deklaronte se "Cogito ego sum" i Kartezit nuk ishte në të vërtetë i domosdoshëm".

Libri i tij i fundit përmbillet me një shënim të ndryshëm, përlësie: një tipar që në pjesën më të madhe të karrierës së tij ka bërë gjoja sikur e ka patur. "Shumë kohë më parë, në rininë time, isha shumë mendjemadh, aq sa të mendoja që mund të shpjegoja "Domethënien e historisë". Sot e di që kjo duhet kërkuar, jo shpallur".

Celësi i realizmit të Kissingerit në politikën e jashtme është tema në qendër të librit të ri dhe kjo përlësi është e rëndësishme jo vetëm për njerëzit, por edhe për shtetet, përfshirë SHBA. Sipas gjykimit të tij, progresi drejt një rendi botëror të bazuar mbi "dinjitetin e shteteve dhe mbi një sistem koordinimi me pjesëmarrje" është një ideal fisnik. "Por ky objektiv final mund të arrihet vetëm nëpërmjet një serie etapash ndërmjetëse".

Walter Isaacson është president i Aspen Institute dhe ish Drejtor i "Time". Është autor i biografive të Henry Kissinger, Beniamin Franklin, Albert Einstein, Steve Jobs etj.



Biznesi i Brukselit: Lobikracia europiane

Il Messaggero

“Njerëzit mendojnë se institucionet europiane janë Komisioni, Këshilli dhe Parlamenti. Por prapa gjithë këtyre fshihen shumë gjëra të tjera”: fjalë të një lobisti

Njerëzit mendojnë se institucionet europiane janë Komisioni, Këshilli dhe Parlamenti. Por prapa gjithë këtyre fshihen shumë gjëra të tjera”. Ai që flet është një lobist në një skenë të “Biznesi i Brukselit”, një film-dokumentar i xhiruar nga F. Moser dhe M. Lietaert, që flet për botën e pabesueshme të lobimeve që vërtitet përreth Brukselit, zemra e teknokracisë europiane. Një ushtri prej 15 mijë profesionistësh (edhe pse është e pamundur të caktosh një shifër të saktë, duke patur parasysh mungesën e transparencës) për një biznes disa miliardësh, i cili është në gjendje të ndikojë, sipas vlerësimeve të Corporate Europe Observatory, 75 % të ligjeve europiane. Duke konsideruar që direktivat europiane kanë ndikim në një përqindje të konsiderueshme të ligjeve të shteteve, duke arritur madje deri në 80 përqind për sektorë si bujqësia dhe tregjet financiarë, mund të nxirren konkluzione pa patur nevojë për shumë fjalë. Me aftësitë e tyre në krijimin e marrëdhënieve si dhe praninë kapilare aty ku duhet të jenë, grupet e

Të bësh lobim është vetëm një çështje rrjeti. "Sapo ke një listë të mirë emrash, të mjafton të kontaktosh me qindra persona vërtetë të rëndësishëm", pohon një lobist, sipas të cilit një rrjet i tillë marrëdhëniesh është jetik për vetë institucionet europianë. Komisioni European në fakt ka nevojë për informacionet e grupeve si European Service Forum, sepse vazhdon lobisti, është në interesin e shoqërive private që shkon të negociojë për hapjen e tregut, i vetmi ideal të cilit i përgjigjet lobisti i vendosur

presionit, përfaqësues në pjesën më të madhe të interesave private, janë në gjendje të ndikojnë në proceset vendim-marrës, pasojat e të cilëve i ndiejnë drejtpërdrejtë 500 milionë persona.

Që nga implementimi i tregut të përbashkët nën udhëheqjen e Jacques Delors e deri në marrëveshjen e sotme TTIP me Shtetet e Bashkuara (për shkëmbimin e lirë të mallrave), e cila pritet të firmoset së afërmi, zotërinjtë e "pushtetit të butë" kanë luajtur gjithmonë një rol vendimtar. Targeti kryesor është Komisioni European, prej ky vijnë të gjithë propozimet për ligje, edhe pse në vitet e fundit presioni ka ardhur duke u rritur edhe mbi Parlamentin European, që ish komisionerja Mariann Fischer Boel e ka quajtur "parajsa e lobeve".

Prania e grupeve të lobimit është justifikuar prej aftësive të tyre teknike në sektorë të ndryshëm, falë të cilëve institucionet europianë arrijnë të hartojnë legjislacion. Ata plotësojnë, për shembull, mangësitë në njohuritë specifike të parlamentarëve dhe komisionerëve, duke vepruar, për shembull, përmes "grupeve të këshillimit", që përbëhen nga zëdhënës të enteve të ndryshëm, kompani, banka dhe shoqata. Ky sistem përballjeje me "shoqërinë civile" në të vërtetë lehtëson propozimin e ligjeve që, duke qenë tashmë në favor të interesave publikë dhe privatë, shmangin politizimin në Këshill. Ky i fundit, me mekanizmat e tij të ndërlikuar të votimit, do të rrezikonte t'i pengonte të gjithë.

Të bësh lobim është vetëm një çështje rrjeti. "Sapo ke një listë të mirë emrash, të mjafton të kontaktosh me qindra persona vërtetë të rëndësishëm", pohon një lobist, sipas të cilit një rrjet i tillë marrëdhëniesh është jetik për vetë institucionet europianë. Komisioni European në fakt ka nevojë për informacionet e grupeve si European Service Forum, sepse vazhdon lobisti, është në interesin e shoqërive private që shkon të negociojë për hapjen e tregut, i vetmi ideal të cilit i përgjigjet lobisti i vendosur. Por edhe duke e pranuar lobizmin si dicka të natyrshme për proceset vendim-marrës në Bruksel, qytetari i paditur europian mundet të paktën të njohë se kush fshihet prapa ligjeve me të cilët ka të bëjë përditë?

Problemi i mungesës së transparencës është ngritur që në vitin 2009, kur komisioneri estonez Siim Kallas propozoi krijimin e një regjistri të grupeve të presionit që veprojnë në Bruksel. Rezultati maksimal që është arritur deri tani ka qenë miratimi i një regjistri ku mund të rregjistrohen vullnetarisht, ndonëse flitet që të bëhet i detyrueshëm gjatë dy viteve të ardhshëm. Në fakt, ka kompani më se të dyshuara. Për shembull, në sektorin financiar mungojnë në apel YBS dhe Goldman Sachs, që rezulton vec të tjerash si financuese e think tank-ut të fuqishëm, Bruegel. Për të mos folur për cilësinë e informacioneve të disponueshëm: secili ent parashikon, përveçse një vlerësim të vetëredaktuar të shpenzimeve të veta për lobim, edhe një listë të temave që i interesojnë. Rezultati: po të shohësh rregjistrin, kup-ton që më pak se pesëdhjetë nga të gjithë entet e rregjistruar kanë bërë të dëgjohet zëri i tyre, sa i përket për shembull marrëveshjes së tregtisë së lirë të sipërpërmendur. E vështirë të besosh që një marrëveshje me rëndësi kaq të madhe i intereson Citigroup dhe IBM, mes të paktave kompani amerikane të pranishme, dhe jo, për shembull, Dhomës Amerikane të Tregtisë. Me një fjalë, përveç dëmit të institucioneve shumë teknokratikë dhe rrejshëm demokratikë, kemi edhe këtë mashtrimin e gjoja transparencës.



Të qeverisësh një botë pa rend

ANNE-MARIE SLAUGHTER

Amund të krijojmë ne një rend ndërkombëtar që do të ruajë paqen dhe do i lejojë shtetet të luajnë sipas rregullave për të cilat kanë rënë dakord? Kjo është pyetja që ngre Henry Kissingeri në librin e tij të ri “Rendi Botëror”. Fatkeqësisht, është pyetja e gabuar.

Kissingeri e përcakton “rendin botëror” si një koncept vetëm marrëveshjes ndërkombëtare që “mendohej të jetë i zbatueshëm për të gjithë botën”. Për shembull, përpara lindjes së Bashkimit Europian, Europa e konceptonte rendin botëror si një ekuilibër mes fuqive të mëdha, ku mund të bashkëekzistonin rajone të shumtë dhe forma të ndryshme qeverisjeje.

Si qytetërim dhe si besim fetar, Islami e sheh shumë ndryshe rendin botëror optimal – si një kalifat, në të cilin feja dhe qeveria janë të bashkuar dhe paqja mbizotëron në Shtëpinë e Islamit. Sigurisht ky nuk është besimi i të gjithë myslimanëve apo i të gjithë qeverive të shteteve me shumicë myslimanësh, por radikalizmi i shfaqur nga grupe si Shteti Islamik kërkon që të përhapë jo vetëm kode të sjelljes, por një këndvështrim të tërë mbi botën.

Në këndvështrimin e Kissingerit, koncepte kundërthënës mbi rendin

Po, pushtimi i Ukrainës nga Rusia ka shkaktuar më shumë se 3000 të vdekur. Por projeksionet aktuale të përhapjes së virusit të Ebolës parashikojnë një milionë raste deri në muajin janar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, epidemia HIV/AIDS ka vrarë 36 milionë vetë, afro dhjetë herë më shumë se sa numri i të vdekurve në veprimet ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që 35 milion të tjerë janë të infektuar

botëror po shfaqen jo vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në Azi. Kina po luan aktualisht sipas rregullave ndërkombëtarë, por ajo po lëshon gjithnjë e më shumë sinjale se pret që të trajtohet si e parë mes të barabartëve. Por teksa Kina forcohet dhe ripretendon atë që beson se është pozicioni i saj historik në Azi dhe në botë, sa kohë do të presë ajo para se të këmbëngulë për të ribërë rregullat ndërkombëtarë?

Rusia po i shkel hapur këta rregulla dhe tani as nuk e merr mundimin të vetëjustifikohet para ligjeve ndërkombëtarë. Ajo madje mburret se po ripretendon territore që dikur sundoheshin nga Kremli dhe kanoset që të përdorë forcën për “të mbrojtur” rusët etnikë nga rreziqet e supozuar. Kur Rusia aneksoi Krimenë në mars, Kadri Liik i Këshillit European për Marrëdhëniet me Jashtë vinte në dukje dallimin e madh me mënyrën si ajo kishte vepruar me pushtimin që i bëri Gjeorgjisë në vitin 2008. Qeveria ruse e provokoi Gjeorgjinë që kjo të sulmonte e para, dhe më pas krijoi një justifikim të rafinuar që synonte të bënte veprat e saj të pajtueshëm me ligjet ndërkombëtarë. Por këtë herë, shkruante Kadriu, “Moska ka sfiduar të gjithë rendin botëror postsovjetik, bashkë me sistemin e tij të vlerave”. Shpresa e Kissingerit se këta vende dhe fuqitë në rritje si India dhe ndoshta edhe Brazili (ai në fakt e lë Amerikën Latine jashtë rrëfimit të tij për rendet botërore) do të jenë në gjendje të bien dakord për një seri rregullash që të gjithë do i shohin si legjitimë, duke ruajtur kështu një ekuilibër global të fuqive. Parimi Vestfalian do të jetë kritik, beson ai, ashtu si do të jetë e domosdoshme që të lejohen vende dhe qytetërime të ndryshëm që të veprojnë mbi parime të brendshëm shumë të ndryshëm.

Megjithatë, një rend botëror efikas për shekullin 21 duhet të bëjë shumë më tepër se sa thjeshtë të ruajë paqen. Kissingeri fokusohet në marrëdhëniet mes shteteve – se si, nga këndvështrimi i një shteti, të shmangët lufta me vendet e tjerë ndërkohë që i pengon këta të jenë agresivë apo të kryejnë veprime që prishin një ekuilibër rajonal apo global të fuqive. Megjithatë, një vështrim i shpejtë i titujve të gazetave të këtyre ditëve tregon se gjërat që me shumë gjasë do të shkaktojnë vdekjen apo zhvendosjen e miliona, në mos qindra miliona njerëzve në dekadat që do të vijnë janë rreziqet globale si epidemitë, ndryshimi i klimës, si dhe rrjetet terroristë dhe kriminalë – jo luftërat mes shteteve.

Po, pushtimi i Ukrainës nga Rusia ka shkaktuar më shumë se 3000 të vdekur. Por projeksionet aktuale të përhapjes së virusit të Ebolës parashikojnë një milionë raste deri në muajin janar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, epidemia HIV/AIDS ka vrarë 36 milionë vetë, afro dhjetë herë më shumë se sa numri i të vdekurve në veprimet ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që 35 milion të tjerë janë të infektuar.

Shumë prej këtyre rreziqeve globale janë ngushtësisht të lidhur me luftën, por me luftëra që ka më shumë gjasa të zhvillohen brenda kufijve, se sa ndërmjet tyre. Mendoni që afro dy të tretat e popullsisë së Sirisë është zhvendosur për shkak të luftës civile në vend, teksa miliona njerëz jetojnë mjerisht në kampet e refugjatëve.

Gjendja shkatërrimtare e shtetit në Liberi dhe Sierra Leone, ku Ebola po bën kërkinë, reflekton disa dekada luftërash të tmerrshme civile në të dy këta vende. Dhuna në rajonet e Liqeneve të Mëdhenj të Afrikës, që ka marrë miliona jetë, i ka rrënjët në gjenocidin e vitit 1994 në Ruandë si dhe vërshimin e refugjatëve Hutu në shtetet fqinjë.

Thatësisht dhe përmbytjet e shkaktuara prej ndryshimit të klimës do të vënë në lëvizje miliona vetë, fillimisht në qytete të mbipopulluar dhe më pas përtej kufijve. Rusia dhe Kanadaja mund të jenë të lumtura t’i mirëpresin për shkak të disponueshmërisë së tokave të reja, por shumë pjesë të tjera të botës janë të mbipopulluara tashmë, dhe ky është një parashikim për konflikte.

Ruajtja e paqes është kryesisht çështje vetëpërmbytjeje. Bashkëpunimi efikas global kërkon shumë më tepër. Qeveritë duhet të jenë në gjendje të

ulen së bashku, bashkë me aktorë jetikë nga biznesi dhe shoqëria civile, për të përshtatur plane veprime gjithëpërfshirës.

Këta plane, nga ana tjetër, do të kërkojnë financime, fuqi njerëzore, vullnet dhe aftësi zbatuese. Megjithatë sot, të gjendur përballë një virusi që vret gjysmën e atyre që infekton dhe me perspektivën që do të bëjë kërdinë mbi të gjithë rajonin e Afrikës, do të ndalë udhëtimin ajror dhe do të fusë në karantinë njerëzit përreth botës, bota ka dhënë vetëm një pjesë shumë të vogël të ndihmës financiare dhe asistencës materiale që nevojitet.

Ne jetojmë në një botë problemesh globale dhe zgjidhjesh kryesisht kombëtare. Nevoja për institucione që mundën të reagojnë me shpejtësi dhe efektivitet, sic bëjnë qeveritë në shtetet e mirëqeverisur, është më e madhe se kurrë. Institucionet e pas Luftës së Dytë Botërore janë bërë të pamjaftueshëm. Është koha që të reformohen – si dhe të ngrihen struktura të reja si dhe mjete për të zgjidhur këta probleme globale.

Anne-Marie Slaughter, ish Drejtore e planifikimit të politikave në Departamentin e Shtetit në SHBA është Presidente e Fondacionit Amerika e Re si dhe Professore e Politikës dhe Çështjeve Ndërkombëtare në Universitetin e Princetonit



Fuqia e shtetit dhe hija e mafias

ED VULLIAMY

Dëshmia e Napolitanos të bën të mendosh se marrëdhënia mes pushtetit dhe hijeve ka qenë gjithmonë. Dhe që në atë periudhë të luftës së mafias kundër shtetit, po kontrakttoheshin detajet e atyre marrëveshjeve të parrëfyeshme për të ruajtur status quo-në. E gjithë kjo ndodhte pavarësisht dukjes: bota e errët e Demokracisë Kristiane të Andreottit, me hijet e tij misterioze dhe kthjelltësinë e tij katolike, ia kish lënë vendin një bote të re më vulgare, me balerina gjysmë të zhveshura dhe striptizë në kanalet televizivë të kryeministrit të ri

Edhe në Itali nuk është e zakonshme që një kryetar shteti të dëshmojë në një proces kundër mafias. Dëshmia e Giorgio Napolitanos në Quirinale, përballë ekipit antimafia të Palermos, nuk ka precedentë. Në 28 tetor, presidenti dëshmoi për tre orë, në kuadër të procesit kundër bosit të Cosa Nostra-s, Salvatore Riina dhe të akuzuarve të tjerë, në përp-

Në të vërtetë, sot e dimë që seria e atentateve mafiozë të viteve 1992 dhe 1993 kishte të gjithë shenjat e atyre viteve, kur unë isha student në Itali. Rrëmbimi dhe vrasja e presidentit të atëhershëm të Demokracisë Kristiane, Aldo Moro nga ana e Brigadave të Kuqe, bomba në stacionin e Bolonjës në vitin 1980 dhe ato të Milanos, Breshias dhe Italicus, ishin të gjitha shprehje e asaj që italianët e quajnë strategjinë e tensionit të bashkërenduar prej shtetit. Ishin të përfshirë dy ekstremet, i djathtë dhe i majtë, shërbimet e fshehtë, ushtria, lozha misterioze masone P2 dhe Cosa Nostra

jekje për të pikasur përgjegjësit për një seri sulmesh kundër shtetit italian në vitet nëntëdhjetë: vrasjet e gjykatësve Giovanni Falcone dhe Paolo Borsellino dhe një seri atentatesh të tjerë. Napolitano u përfshi në proces për shkak të një letre në të cilën këshilltari juridik i Quirinales, i ndjeri Loris D'Ambrosio, fliste për një marrëveshje të nivelit të lartë, apo një farë tratative mes Riinës dhe krerëve më të lartë të shtetit.

E mbaj mend mirë atë periudhë, sepse ndiqja ngjarjet në Itali për The Guardian. Sapo kishte shpërthyer skandali i Tangentopolit dhe një klasë e tërë politike ishte nën hetim, por edhe në atë kontekst, ai shpërthim i papritur i dhunës ishte tronditës, të kujtonte të ashtuquajturit vite të plumbit, që Italia besonte se i kishte lënë pas tashmë.

Marrëveshje të parrëfyeshme

Në të vërtetë, sot e dimë që seria e atentateve mafiozë të viteve 1992 dhe 1993 kishte të gjithë shenjat e atyre viteve, kur unë isha student në Itali. Rrëmbimi dhe vrasja e presidentit të atëhershëm të Demokracisë Kristiane, Aldo Moro nga ana e Brigadave të Kuqe, bomba në stacionin e Bolonjës në vitin 1980 dhe ato të Milanos, Breshias dhe Italicus, ishin të gjitha shprehje e asaj që italianët e quajnë strategjinë e tensionit të bashkërenduar prej shtetit. Ishin të përfshirë dy ekstremet, i djathtë dhe i majtë, shërbimet e fshehtë, ushtria, lozha misterioze masone P2 dhe Cosa Nostra. Qëllimi mendohej të ishte shpërthimi i kaosit, me qëllim që të intensifikohej represioni. Me sa duket, dëshmia e Napolitanos ka konfirmuar se nuk ka patur asnjë tratativë mes presidencës së Republikës dhe mafias, por letra e D'Ambrosios për "marrëveshje të parrëfyeshme" të sjell në vëmendje që, në fillimin e viteve nëntëdhjetë, shteti italian ishte në kontakt me mafian. Pak a shumë në të njëjtën periudhë, Giulio Andreotti, Kryeministër dhe simbol i epokës që nisi me vitet e plumbit dhe përfundoi me tangentopolin, u akuzua për lidhje me mafian, u dënua dy herë dhe u shpall jo fajtor në Kasacion. Por historia nuk përfundon këtu. Nuk është një ko incidencë që vala e arrestimeve dhe sulmeve mafiozë të viteve 1992 dhe 1993 ndodhi pikërisht në periudhën kur thuhet se Andreotti u takua me përfaqësuesit e Riinës. Në majat e pushtetit po hapej një boshllëk dhe ekzistonte frika që mund të mbushej nga komunistët, edhe pse Partia Komuniste Italiane kishte ndryshuar emër dhe kish hequr dorë nga simboli i kosës dhe çekanit.

Ai boshllëk duhej plotësuar për të ruajtur status quo-në, domethënë ndërthurjen e marrëdhënieve mes shtetit, krimit të organizuar, masonerisë dhe botës së biznesit. Cuditërisht, pak më vonë ekipi antimafia i Caltanissettas, qyteti sicilian i konsideruar si bastioni i Cosa Nostra-s, do të duhej të hapte një hetim edhe ndaj Silvio Berlusconi dhe krahut të djathtë të tij, Marcello Dell'Utri, i cili në fillimet e viteve nëntëdhjetë kishte shtyrë Kavalierin që të hynte në politikë, për të garantuar imunitetin dhe për të forcuar aleancat e vjetra.

Hetimi u arkivua kur Berlusconi, nën udhëheqjen e Dell'Utrit fitoi zgjedhjet e vitit 1994, duke hapur atë që u duk se do të ishte një epokë e re, por që në realitet nuk ishte veçse një vazhdimësi e paraardhëses. Nuk dyshohet që Berlusconi dhe Dell'Utri të kenë pasur të bëjnë me vrasjet e Falcones dhe Borsellinos, as me bombat e vëna në Firenze dhe në Romë. Por odisea e Berlusconi nëpër një seri gjykatash është legjendare. Ndërkohë, Dell'Utri është dënuar për lidhje me mafian dhe në prill u arrestua në Liban, ku ishte strehuar pas largimit nga Italia.

Shumëkush e ka quajtur ambasador të Berlusconi pranë Cosa Nostra-s, dhe e anasjellta, edhe pse Berlusconi ka mohuar gjithmonë çfarëdolloj lidhjeje me organizatën mafioze. Bashkëpunëtori tjetër i ngushtë i tij, Cesare Previti, u dënua për korrupsion.

Rafte të tërë me libra

Dëshmia e Napolitanos të bën të mendosh se marrëdhënia mes pushtetit dhe hijeve ka qenë gjithmonë. Dhe që në atë periudhë të luftës së mafias kundër shtetit, po kontrakttoheshin detajet e atyre marrëveshjeve të parrëfyeshme për të ruajtur status quo-në. E gjithë kjo ndodhte pavarësisht

dukjes: bota e errët e Demokracisë Kristiane të Andreottit, me hijet e tij misterioze dhe kthjelltësinë e tij katolike, ia kish lënë vendin një bote të re më vulgare, me balerina gjysmë të zhveshura dhe striptizë në kanalet televizivë të kryeministrit të ri.

Por në të vërtetë asgjë nuk kishte ndryshuar, përveç zëvendësimit të kultit të shtetit me atë të fuqive ekonomike. Marrëveshjet e parrëfyeshme ishin respektuar. Por, gjëja më interesante është që në Itali ishte bërë gjithçka për të denoncuar këto drama: nëse hyni në cilëndo librari Feltrinelli, do të gjeni rafte të tërë me libra të mbushur me hollësira, të shkruajtur nga gazetarë kurajozë në bashkëpunim me magjistratë po kaq kurajozë.

Në Itali është zbuluar ekzistenca e lidhjeve mes pushtetit dhe krimit të organizuar. Por nuk mund të themi të njëjtën gjë për vendin tonë (Britaninë e Madhe) dhe për marrëveshjet e parrëfyeshme që lejojnë persona të ngjashëm me Berlusconi që të fshehin kapitalet e tyre në parajsë fiskale, nën juridiksionin britanik. Dëshmia e 28 tetorit konfirmoi se në Itali, vija ndarëse mes ligjshmërisë dhe kriminalitetit është një gënjeshtër, nuk ekziston. Dhe na ka kujtuar ne britanikëve se kemi mbetur shumë prapa në vetëdijësimin për këtë gënjeshtër dhe në denoncimin e marrëveshjeve të parrëfyeshme që mbajnë të bashkuar shoqërinë tonë./The Guardian/

www.asp.al



www.bota.al